BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M2-2019

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

P Ë R M B A J T A

E ARDHMJA E BANKINGUT NË RAJONIN EQJL DHE NË SHQIPËRI. NJË ANALIZË E MUNDËSIVE DHE RREZIQEVE PËRPARA *5*
Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

CIKLET E BIZNESEVE NË OPTIKËN E TREGUESVE TË BESIMIT *19*
Ermelinda Kristo, Rajna Hoxholli, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

IMPAKTI I FAKTORËVE SEZONALË NË INFLACIONIN E PERIUDHËS 2008-2018 NË SHQIPËRI *35*
Gent Hashorva, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

SFIDAT E EKONOMISË SHQIPTARE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM AFATGJATË *45*
Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

DIFERENCAT NË PAGA NË VARËSI TË SEKTORIT TË PUNËSIMIT, NIVELIT ARSIMOR DHE GRUP-PROFESIONIT NË SHQIPËRI *49*
Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

E ARDHMJA E BANKINGUT NË RAJONIN EQJL DHE NË SHQIPËRI. NJË ANALIZË E MUNDËSIVE DHE RREZIQEVE PËRPARA

Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Kriza financiare globale ishte një sfidë si për vendet e Bashkimit Evropian, ashtu edhe për vendet evropiane në zhvillim. Pavarësisht rrezikut ndaj stabilitetit ekonomik dhe financiar, rajoni EQJL arriti ta tejkalojë pa përjetuar një kolaps financiar. Kjo për arsye të një sistemi bankar të qëndrueshëm, mbështetjes nga jashtë të BQE-së, FMN-së, Bankës Botërore dhe Iniciativës së Vjenës e gjithashtu falë një reagimi të mirëkoordinuar dhe agresiv të politikës së brendshme (Klingen et al. 2013).

Grafik 1. PBB, zhvillimet e inflacionit dhe parashikimet.



Burimi: FMN, World Economic Outlook Database, Tetor 2019.

Pas krizës, ekonomia globale dhe rajoni EQJL arritën të kufizojnë ndikimet e tërthorta të mundshme makroekonomike dhe financiare që vinin nga kriza dhe kanë përjetuar rritje ekonomike përgjatë viteve të fundit. Në vitin 2018, perspektiva ekonomike globale ishte shumë optimiste. PBB-ja globale regjistroi 3,8% dhe norma e papunësisë arriti në nivelet e para-krizës (BIS, 2018). Nga ana tjetër, trazirat politike ngadalësuan zgjerimin në vitin 2019 dhe do të vazhdojnë edhe në periudhën afatmesme, duke ndikuar kryesisht sentimentin e agjentëve ekonomikë dhe të sektorit industrial. Tarifat e vendosura nga Sh.B.A., pasiguria politike në rritje dhe kushtet financiare më të shtrënguara po kërcënojnë tregtinë globale, investimet, si dhe sigurisht prodhimin (FMN, 2019). Parashikimet e FMN-së janë rishikuar vazhdimisht për poshtë duke filluar nga korriku 2018 dhe aktualisht qëndrojnë në 3%, vlera më e ulët që nga viti 2009. Sidoqoftë, perspektiva e rritjes së vendeve të EQJL-së ka qenë më optimiste se ajo globale dhe ajo për vendet e zhvilluara. Rajoni është rritur mesatarisht me 3,6% në vitin 2018 dhe me 3% në vitin 2019, me disa vende me ecuri më të mirë se të tjerat, dhe parashikohet të rritet me 3,2% në periudhën afatmesme. Parashikimet për Shqipërinë janë shumë premtuese, në

3,9% (FMN, tetor 2019). Inflacioni nga ana tjetër, si në BE dhe në rajon, ka vazhduar të qëndrojë poshtë objektivit, por pritet të arrijë objektivin në periudhën afatmesme.

Në këtë situatë, ekonomia globale po përjeton shumë sfida. Sfida e parë është një mjedis që karakterizohet nga norma të ulëta interesi. Si rezultat, sektori financiar ka marrë një rol të rëndësishëm në ndikimin e ciklit të biznesit. Aktualisht, sektori financiar është i qëndrueshëm, por kushtet financiare mbeten lehtësuese dhe si rezultat, dobësitë financiare janë rritur në shumë rajone, duke përfshirë Evropën dhe vendet evropiane në zhvillim (BIS, 2019). Rreziqet ndaj stabilitetit financiar kanë të bëjnë kryesisht me një shtrëngim të kushteve financiare në të ardhmen, rritje më të dobët ekonomike dhe pasiguri politike dhe gjeopolitike (FMN, tetor 2019).

Për sa i përket EQJL-së, duke marrë në konsideratë që rajoni nuk ishte po aq fitimprurës sa para krizës, disa banka evropiane morën vendimin të tërheqin filialet e tyre nga tregu i EQJL-së. Në fakt, ishte Iniciativa e Vjenës I dhe II që frenoi tërheqjen e filialeve nga rajoni. Por nga ana tjetër, ishte e pamundur për Iniciativën e Vjenës të ndalonte tërësisht këtë dukuri (Gunter dhe Epstain, 2019). Kjo ishte veçanërisht e vërtetë, por jo ekskluzive, për bankat greke që u goditën më fort dhe nga kriza greke në vitin 2012 dhe shumë e prekshme në Shqipëri, ku filialet gjendeshin, kryesisht për shkak të afërsisë mes vendeve, por edhe në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Gjatë viteve 2017 dhe 2018, kanë ndodhur ndryshime në madhësinë, përqendrimin dhe pronësinë e sektorit bankar. Në vitin 2019, sektori bankar shqiptar përbëhej nga 12 banka, nga 16 në vitin 2017 (Banka e Shqipërisë, 2019).

Grafik 2. Pronësia e kapitalit bankar sipas vendit të origjinës, fundi i vitit 2019*



Burimi: Banka Kombëtare e Austrisë, 2019 (majtas) dhe Banka e Shqipërisë 2019 (djathtas).

* *"Banka Intesa SanPaolo" përfundoi bashkimin me përthithje të "Bankës Veneto" në vitin 2018. Gjithashtu në vitin 2018, "Grupi OTP", një lojtar dominues në Ballkanin Perëndimor, bleu "Societe Generale" pas vendimi të kësaj të fundit për tërhiqjen e plotë nga rajoni dhe ka shprehur hapur ambicien për tu zgjeruar më tej në tregun shqiptar. "Banka Tirana" u ble nga "Balfin Sh.P.K", një korporatë shqiptare dhe nga banka maqedonase "Komercijalna A.D." Banka "Credit Agrikole" u ble në vitin 2015 nga "TRANZIT SH.P.K", një subjekt financiar jo-bankë që vepron në Shqipëri që në vitin 2010 dhe që gjithashtu u zgjerua duke blerë {Bankën Kombëtare të Greqisë (NBG) në vitin 2018. "Union Bank", një bankë vendase, u zgjerua duke blerë "Bankën Ndërkombëtare Tregtare" në vitin 2018. Së fundmi, Banka e Shqipërisë vendosi të heqë licencën e dhënë për "Bankën e Kreditit të Shqipërisë", për shkak të procesit të likuidimit vullnetar të bankës.*

Ndryshimet në sektorin bankar në Shqipëri dhe në rajon në përgjithësi, nuk sollën një kërcënim për stabilitetin financiar, dhe u menaxhuan pa probleme si nga aktorët vendas, ashtu edhe ata të huaj. Gjithashtu, procesi i ngadaltë dhe i mirë-menduar nuk ndikoi mbi sentimentin e sektorit privat ndaj sektorit bankar dhe për këtë arsye mund të konsiderohet i suksesshëm. Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje dinamikave të tregut, duke monitoruar dhe mbikëqyrur nga afër bankat "e reja", për të vlerësuar strategjitë e zhvillimit dhe zbatimin e tyre, dhe gjithashtu duke rishikuar strategjitë e administrimit të rreziqeve dhe proceseve të brendshme me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me pritshmëritë rregullatore e mbikëqyrëse. (Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, 2018).

Megjithatë, tregu bankar mund të mos jetë konsoliduar përfundimisht. Bankat që vendosën të vazhdojnë të veprojnë në vendet EQJL po konsiderojnë të pozicionohen në mënyrë strategjike, pra të tërhiqen ose të minimizojnë operacionet e tyre në një vend, dhe të rrisin praninë e tyre në një tjetër. Përkundrazi, është vërejtur një interes në rritje nga bankat dhe aktorët e tjerë të rajonit për t'u zgjeruar në tregun e tyre ose në vendet e tjera, duke blerë filiale të shitura nga bankat e BE-së.

Grafik 3. Operacionet bankare në EQJL, gjysma e dytë e vitit 2019.



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, EIB, 2019 H2.

Disa nga pyetjet që lindin në këtë kontekst janë: Çfarë do t'i ndodhë rritjes, integrimit financiar dhe ekonomik dhe së fundmi stimulit integrues të BE-së, nëse grupet bankare të BE-së zëvendësohen nga grupe bankare jo-BE? A do të asistohet rajoni EQJL në të njëjtën mënyrë në operacionet e përditshme dhe në rast të një tjetër krize financiare nga BE-ja dhe institucionet ndërkombëtare dhe nëse jo, a ka për të pasur ndonjë ndërhyrje nga vendet mëmë? Për më tepër, lindin disa pyetje mbi mbikëqyrjen. Aktualisht, grupet bankare të BE-së janë "dyfish" të mbikëqyrura, bankat mëmë mbikëqyren nga bankat qendrore të tyre dhe filialet nga bankat qendrore vendase. A do të jetë mbikëqyrja po aq efikase për bankat vendase dhe grupet bankare jo-BE?

Bankat e BE-së kanë provuar, veçanërisht para krizës, kur rajoni po hidhte hapat e parë në krijimin dhe zhvillimin e sektorit të tij financiar, se janë motori i integrimit të shpejtë financiar dhe i procesit të zhvillimit në rajon, dhe veçanërisht thelbësore për krijimin e një kuadri ligjor-rregullator modern. Në fakt, shumë ekonomistë besojnë që kriza financiare u zbut kaq shumë për

shkak të pranisë së ndjeshme të grupeve bankare të BE-së në rajon, ku në disa vende ishte më lartë se 90% (Arakelyan, 2019). Grupet bankare të BE-së kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e rritjes ekonomike (De Haas et al., 2015). Në materialin e tyre studimor, Sejko dhe Dushku (2017) në fakt gjejnë se, në rastin e Shqipërisë, ekziston një marrëdhënie e fortë kointegruese ndërmjet zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike. Shumë studime të ngjashme tregojnë të njëjtën gjë për vende të tjera të EQJL-së, si dhe për rajonin në tërësi (Klein, 2013).

Për më tepër, prania e tyre ka ankoruar përmirësimin ligjor dhe rregullator që ka qenë thelbësor për procesin e integrimit në BE. Prania e filialeve të BE-së në rajonin EQJL ka bërë të mundur krijimin e një marrëdhënieje të fortë dhe konvergjente ndërmjet sistemit bankar dhe financiar të BE-së, institucioneve mbikëqyrëse të BE-së dhe institucioneve përkatëse në ekonomitë e vendeve pritëse (Sanfey Milatovic dhe Kresic, 2016). Nga ana tjetër, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor tashmë janë ngushtësisht të integruara me BE-në. BE-ja është partneri i tyre më i madh tregtar, burimi më i madh i investimeve të huaja dhe flukseve financiare hyrëse të tjera, dhe pikëmbërritja kryesore e emigrimit (Dabrowski dhe Myachenkova, 2018). Për shkak të këtyre marrëdhënieve me BE-në, efektet e politikave të BE-së ndikojnë sjelljen në vendet e EQJL-së.

Aktualisht, mjedisi rregullator për institucionet financiare është në përgjithësi i mirë në rajon dhe është përmirësuar në tërësi gjatë dekadës së fundit, pjesërisht i nxitur nga rritja e adoptimit të praktikave të BE-së. Në rajon, treguesit e kapitalit dhe të likuiditetit të sektorit bankar raportojnë për vlera të qëndrueshme. Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit tejkalon minimumin rregullator. Vazhdimesia në fshirjen e kredive të humbura nga bilanci i bankave ka sjellë ngadalësimin e rritjes së kredive me probleme. Situata e likuiditetit gjithashtu mund të vlerësohet si e favorshme, që sugjeron që bankat duhet të jenë në gjendje të përballojnë goditje të papritura. Treguesit e likuiditetit tregojnë për një rënie graduale, me zhvillimin dhe thellimin e rolit ndërmjetësues të bankave. Sidoqoftë, Raporti i Likuiditetit dhe i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të bankave ndryshon nga një vend në tjetrin.

Grafik 4. Treguesit kryesorë të performancës së sektorit bankar në EQJL.



Burimi: FMN, Treguesit e Qëndrueshmërisë Financiare, 2020.

Nga ana tjetër, përfitueshmëria e filialeve të BE-së nuk ka qenë aq e lartë sa para krizës. Bankat evropiane, në përgjithësi, janë duke perjetuar një nivel përfitueshmërie më të ulët se para krizës, dhe kanë filluar të rriten me një normë premtuese vetëm në vitin 2019. Në Eurozonë, përfitueshmëria e ulët mund të shpjegohet nga pasojat e krizës, mjedisi makroekonomik që ka qenë i karakterizuar për një kohë të gjatë nga norma të ulëta interesi, dhe në disa raste nga faktorë strukturorë, në veçanti nga kapaciteti i tepërt i sektorit bankar (Constâncio, 2016). Këto efekte kanë pasur një ndikim të tërthortë edhe në filialet e BE-së.

Si rezultat, kushtet e ofertës kanë qenë të shtrënguara, duke filluar që nga viti 2013, por janë zhvilluar pozitivisht duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2018. Numri i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që kufizonin ofertën ka rënë ndjeshëm në krahasim me vitin 2013. Duke parë të dhënat e vetë-raportuara nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), mund të vërehet që një nga arsyet kryesore që bankat kanë qenë të kujdesshme në kreditim në të kaluarën, janë shifrat lokale të kredive me probleme. Në krahasim me mesataren e EQJL-së, ndikimi ishte më i fortë në Shqipëri dhe Serbi, sepse niveli i kredive me probleme ishte më i lartë. Dy strategji të mëdha në këto dy vende janë iniciuar në gjysmën e dytë të vitit 2015, duke mbuluar mbikëqyrjen bankare, çështjen e taksave, procedurat gjyqësore dhe aspektet ligjore, ndërmjet të tjerave (FMN, 2017). Në Shqipëri, raporti i kredive me probleme ka rënë që nga vlera e tij më e lartë në vitin 2014, në gati 25%. Gjatë vitit 2019, kreditë me probleme në Shqipëri kanë qenë të qëndrueshme në 10-11% të kredisë totale dhe në nëntor zbritën për herë të parë nën 10%, në 9,53% (Banka e Shqipërisë, 2019).

Grafik 5. Faktorët e brendshëm që ndikojnë mbi ofertën e kredisë 2014-2019.



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kreditues, BEI, 6MI/2014-6MII/2019.

Lajmi i mirë është që përgjigjja agresive ka pasur një ndikim pozitiv, jo vetëm mbi shifrat e kredive me probleme, por edhe mbi ndjesinë e bankave ndaj tyre dhe mbi kreditimin. Duke filluar nga vrojtimi në gjysmën e dytë të vitit 2017, bankat raportojnë se niveli lokal i kredive me probleme përkundrazi, ka pasur

një ndikim pozitiv mbi kreditimin, megjithëse kreditë me probleme në nivel grupi kanë ende një efekt shtrëngues mbi ofertën e kredisë.

Në përgjithësi gjatë vitit 2019, dhe në veçanti gjatë gjysmës së dytë të tij, ka pasur një përmirësim të qartë në mjedisin e brendshëm dhe një qëndrim optimist ndaj rajonit EQJL në tërësi. Pjesa më e madhe e faktorëve vendas dhe ndërkombëtarë nuk e kufizojnë më ofertën, megjithatë këta të fundit nuk janë kontribuues pozitivë të rëndësishëm. Bankat raportojnë një qëndrim optimist ndaj përfitueshmërisë dhe rritjes së kredisë, megjithëse pritjet duhen interpretuar me kujdes në këtë moment, për shkak të paqëndrueshmërisë së mundshme në fazën aktuale të ciklit global ekonomik dhe financiar (BEI, 2019). Sipas të dhënave (siç tregohet në Grafikun 6), oferta e kredisë ka qenë gjithmonë e ndjeshme ndaj perspektivës makroekonomike globale, dhe gjithashtu aktiviteti real në vendet e EQJL-së është mjaft i ndjeshëm ndaj ndryshimeve në kushtet financiare globale (Mihaljek, 2019).

Grafik 6. Faktorët ndërkombëtarë që ndikojnë mbi ofertën e kredisë 2014-2019.



Burimi: Vrojtimi i aktivitetit kredituës, BEI, 6MI/2014-6MII/2019.

Për më tepër, oferta e kredisë ka qenë gjithashtu e ndikuar nga kuadri rregullator, si ai i brendshëm, ashtu edhe ai i BE-së. Shumë studime kanë treguar që rregulloret bankare nga bankat qendrore në fakt ndikojnë si kreditimin e bankave të tyre, ashtu edhe standardet e kreditimit në vendet e tjera (IMF, 2017). Meqenëse rregulloret janë forcuar që prej vitit 2009, ato kanë pasur tendencën të krijojnë më tepër ndërlikime, dhe me këtë vjen një kosto e pashmangshme, për sa i përket pajtueshmërisë (Mersch, 2015). Por në botën e sotme, bankat qendrore konsiderojnë stabilitetin financiar një prioritet kryesor. Kriza globale ka treguar shumë qartë rëndësinë e të pasurit të mbrojtjes së duhur për të parandaluar marrjen e rrezikut të tepërt dhe krijimin e flluskave të kredisë. Bankat qendrore në rajon kanë qenë prej kohësh në procesin e krijimit të kuadrove rregullatore për të përforcuar mbikëqyrjen bankare, përmirësuar administrimin e rrezikut dhe standardet e qeverisjes, dhe rritur transparencën dhe publikimin e statistikave (Jazbec et al., 2015).

Këto aspekte prudenciale të kuadrit të stabilitetit financiar kanë si qëllim të zvogëlojnë amplitudën e cikleve financiare. Rregulloret ndihmojnë për të kufizuar dobësitë e bilancit të bankave, të cilat janë akumuluar gjatë ciklit të "bum/bust" të kredisë , dhe gjithashtu për shkak të periudhës së fundit karakterizuar nga norma të ulëta të interesit. Sipas këtyre konsideratave, përmirësimi i bilancit të sektorit bankar dhe sektorit të korporatave është një përparësi për "zhbllokimin" e rritjes së kredisë (Jazbec et al. 2015). Nxitja e rritjes së kredisë pa adresuar mungesën e balancave agregate në ekonomi mund të jetë problematike. Është e rëndësishme që huamarrësit e mirë, e jo ata të këqij, të jenë përfituesit kryesorë nga rritja e kredisë.

Nga ana tjetër, rritja e fortë e kërkesës për kredi në EQJL gjatë viteve të fundit ka krijuar një hendek ndërmjet ofertës dhe kërkesës. Kërkesa është rritur për shkak të rritjes së investimeve, kapitalit qarkullues, strehimit dhe besimit konsumator dhe pritet të vazhdojë të rritet në të ardhmen (BEI, 2019).

Grafik 7. Kredia për sektorin privat, niveli i rritjes vjetore.



Burimi: BEI, 2019.

Sidoqoftë, rritja e kredisë është në territor pozitiv dhe mesatarisht kredia e re është e një cilësie më të mirë. Kjo nënkupton që si ambienti makroekonomik, ashtu edhe ai financiar janë përçues të konsumit dhe investimeve. Në Shqipëri, kreditimi i sektorit privat është përmirësuar, duke regjistruar një rritje vjetore prej 7,5% në tremujorin e tretë të vitit 2019, nga përkatësisht 6,7% dhe 5,9% në tremujorin e parë dhe të dytë (Banka e Shqipërisë, Raport i Politikës Monetare, T4-2019). Rritja e kreditimit është mbështetur kryesisht nga kredia për sektorin e korporatave dhe gjithashtu nga kredia konsumatore. Kredia për bizneset e vogla dhe të mesme është përmirësuar në Shqipëri, dhe gjithashtu në të gjithë rajonin gjatë vitit 2019, por hendeku ndërmjet ofertës dhe kërkesës mbetet ende i hapur.

Në këtë kontekst, financimi i bizneseve të vogla e të mesme ka qenë gjithmonë thelbësor për rritjen ekonomike, veçanërisht në rajon dhe në Shqipëri, ku bizneset e vogla e të mesme përbëjnë një peshë të rëndësishme të prodhimit total dhe të punësimit. Bizneset e vogla e të mesme luajnë një rol kryesor në ekonominë rajonale dhe shqiptare, duke kontribuar me më tepër se gjysmën

e punësimit dhe të vlerës së shtuar. Qasja në financim është ndër pengesat kryesore për të bërë biznes (Hauser et al., 2016; Sanfey dhe Milatovic, 2018). Bankat në rajon dhe Shqipëri kanë një qëndrim të fortë ndaj marrjes përsipër të rrezikut kundrejt bizneseve të vogla e të mesme, duke i vënë kërkesat ndaj tyre për kolateral deri në 200% të vlerës së kredisë (Dushku dhe Ceca, 2019). Dy vrojtime kryesore të kryera nga Banka e Shqipërisë, më specifikisht "Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Mikro-Bizneseve në Shqipëri" dhe "Vrojtimi mbi Gjendjen Financiare dhe Huamarrjen e Bizneseve Bujqësore në Shqipëri", tregojnë se bizneset e vogla e të mesme në përgjithësi, dhe ato në sektorin bujqësor në veçanti, kanë mungesë financimi. Burimi kryesor i financimit për mikro-bizneset janë shitjet dhe fondet e veta. Vetëm 26% e mikro-bizneseve ka një kredi për të paguar, ndërsa 76% raportojnë që nuk kanë një të tillë. Ndërsa në sektorin e bujqësisë, vetëm 18% e bizneseve kanë një kredi për të paguar. Nga bizneset që kanë kredi për të paguar, 53% e mikro-bizneseve kanë marrë hua nga bankat, ndërsa 34% prej tyre nga një individ. 92% e bizneseve bujqësore nuk aplikojnë për një kredi bankare, sepse: nuk u duhet për biznesin e tyre (41% i bizneseve), procesi iu duket i vështirë (32% të bizneseve) dhe mund të marrin hua lehtësisht nga burime të tjera (21% i bizneseve). Ndërkohë, bankat mbeten burimi kryesor i financimit për ekonomitë e EQJL-së, meqenëse tregjet financiare në rajon janë kryesisht me bazë bankare (Arakelyan dhe Mühlberger 2015).

Bazuar mbi zhvillimet e fundit, bankat jo-BE, subjektet financiare jo-banka dhe veçanërisht risitë teknologjike, duke përfshire Fintech dhe Bigtech, kanë potencialin për të ndihmuar. Sfidat bankare që paraqiten po ndodhin në një kohë ndryshimi teknologjik në sektorin financiar, më konkretisht hyrja dhe interesi në rritje për risitë Fintech, Bigtech dhe kriptovalutat. Pavarësisht se nuk kanë implikime të konsiderueshme në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme për ekonominë shqiptare, potenciali i tyre sërish duhet adresuar për periudhën afatgjatë në rastin e kriptovalutave (për më shumë shih Ahmetaj dhe Hoda, 2019), dhe për sa i përket ndikimeve të tërthorta nga tregjet e huaja në rastin e Fintech dhe Bigtech (për më shumë shih Hoda, 2019, për t'u botuar).

Fintech, e cila i referohet risive teknologjike në shërbimet financiare, ka fituar popullaritet kohët e fundit. Aktivitetet e firmave teknologjike të mëdha (Bigtech) në financë janë një rast i veçantë i risive Fintech. Ndërsa kompanitë Fintech janë ngritur që të operojnë kryesisht në shërbime financiare, firmat Bigtech ofrojnë shërbime financiare si pjesë e një game më të gjerë aktivitetesh. Bigtech si Google, Alibaba, Ebay etj. kanë një potencial të madh për të iniciuar ndryshime të rëndësishme në tregjet financiare globale për shkak të aftësisë së tyre për të mundësuar ndërveprimin e drejtpërdrejtë ndërmjet një numri të madh përdoruesish dhe për të menaxhuar një sasi të madhe të dhënash me kosto margjinale zero. Pavarësisht se disa Bigtech kanë filluar të angazhohen në ofrimin e shërbimeve financiare, profili financiar përbën vetëm një pjesë të vogël të biznesit të tyre global dhe një pjesë të vogël të transaksioneve financiare në ato vende. Nga ana tjetër, ndikimi i tyre ka potencialin të jetë i shpejtë dhe i fuqishëm në rast të një rritjeje të mëtejshme dhe nuk duhet nënvleftësuar.

DNA-ja e Bigtech-eve (analiza e të dhënave, eksternalitetet e rrjetit dhe aktivitetet e ndërthurura), e cila përbën tiparin kryesor të modelit të tyre të biznesit, është ndoshta karakteristika më interesante e Bigtech-ve. Qarku i feedback-ut të DNA-së fillon me numrin në rritje të përdoruesve, për të prodhuar më tepër të dhëna të cilat sigurojnë më tepër input për analizën e të dhënave dhe kështu për rrjedhojë sjellin një numër më të lartë përdoruesish. Prandaj DNA-ja ka avantazhin e analizimit të një game të gjerë të të dhënave digjitale me një kosto margjinale shumë të ulët deri në zero. Këto teknologji të reja që kanë filluar të përhapen në shume degë si pagesat, huatë me vlerë të vogël, menaxhimi i aktiveve deri dhe në tregun e sigurimeve, kanë potencialin të sjellin përfitime në terma të efikasitetit. Ka tre mënyra të mundshme me të cilat tregu financiar mund të përfitojë: e para, nëpërmjet zgjerimit dhe rritjes së Bigtech-ve për t'u bërë pjesë thelbësore e sistemit financiar; e dyta, nëpërmjet bankave që përfitojnë nga informacioni dhe teknologjia që DNA-ja vë në dispozicion; dhe e fundit, një kombinim i të dyjave.

Bankat, madje edhe ato të mëdha, nuk kanë qenë aq efektive sa Bigtech-ët në shfrytëzimin e qarkut të feedback-ut të DNA-së. Kostot e bankave në hulumtimin e klientëve janë të larta dhe mund të jenë asimetrike, pasi bankat kanë në dispozicion kryesisht të dhënat e transaksioneve dhe regjistrin e kredisë. Më vete, Bigtech mund të ndihmojë rritjen e kredisë me rrezik të ulët, por ato gjithashtu mund të ndihmojnë bankat në ofrimin e shërbimeve financiare, duke zvogëluar koston e informacionit dhe të transaksioneve dhe për këtë arsye të promovojnë shpërndarjen më efikase të burimeve dhe të përmirësojnë përfshirjen financiare. Duket më se normale që bankat, nën kushtet e reja të konsolidimit, do të kërkojnë rrugë të reja për të depërtuar në treg, nën presionin konkurrues, dhe mënyra më e mirë për të arritur një objektiv të tillë janë padyshim produktet inovative, të cilat do të zgjerojnë më tej marrëdhëniet e bankave me klientët e tyre, duke ulur kështu kostot e shërbimit.

Nga ana tjetër, me rritjen e kërkesave të klientëve, subjektet financiare jobanka, duke përfshirë Fintech dhe Bigtech, mund të bëhen konkurrues me të vërtetë agresivë të sektorit bankar. Në fakt, Bigtech që tani ka infrastrukturën, aftësitë, burimet dhe klientët e nevojshëm për të tërhequr një pjesë të tregut të bankave (BIS, 2017). Cili do të jetë ndikimi i hyrjes së firmave të reja dhe përdorimi i teknologjive të reja në furnizimin e shërbimeve financiare është e vështirë për t'u parashikuar për shkak të literaturës kontradiktore që analizon raportin ndërmjet konkurrencës dhe stabilitetit financiar. Shumë ekonomistë argumentojnë që do të varet nga stimuli i aktorëve individualë në treg dhe gjithashtu nga karakteristikat e sistemit (Bundesbank, 2019). Në Shqipëri, dy studime në Bankën e Shqipërisë pajtohen që konkurrenca aktuale promovon stabilitetin financiar (Dushku, 2016; Shijaku, 2017), por meqenëse keto studime nuk marrin parasysh potencialin e konkurrentëve të rinj në treg, pyetja nuk mund të marrë një përgjigje për rastin e Shqipërisë. Ajo që mund të supozohet është se ato me shumë mundësi do të paraqesin sfida për praktikat e ardhshme të mbikëqyrjes. Një nga sfidat për sa i përket adoptimit të Fintech dhe Bigtech nga bankat ose si konkurrentë të bankave është koordinimi i autoriteteve për të zbatuar rregullin "i njëjti rrezik, e njëjta rregullore" për hyrjet e reja në treg, por pa kufizuar risinë teknologjike. Për më tepër, Bigtech-ët

zotërojnë sasi të mëdha të dhënash, të cilat jo vetëm që mund të shoqërohen me një rrezik të lartë për mbrojtjen e të dhënave, por edhe me një potencial për diskriminim të çmimeve dhe efekte negative të mirëqenies, të cilat të gjitha paraqesin sfida për ligjvënësit, rregullatorët dhe politikë-bërësit jo vetëm në Shqipëri dhe rajon.

Të dhënat tregojnë se këto teknologji janë përhapur më gjerësisht në vendet në zhvillim, ku përdorimi i kartave të kreditit është i ulët dhe depërtimi i telefonit celular është i lartë (BIS, 2017). Në vendet në zhvillim çfarë duket të jetë me shumë interes është ofrimi i shërbimeve të dërgesave të emigrantëve dhe pagesat me vlerë të vogël ndërkufitare.

Duke marrë parasysh këto zhvillime, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me aktorët e tregut, po ndërmerr reforma me objektivin të modernizojë tregun financiar dhe t'u ofrojë klientëve dhe bizneseve shërbime më efektive dhe me kosto të ulët. Ato, deri tani, synojnë t'u japin përparësi promovimit të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike për të realizuar përfshirjen financiare të popullatës për sa i përket pagesave, si hap i parë në përfshirjen financiare të prodhimeve bankare dhe financiare akoma më të sofistikuara (Banka e Shqipërisë, 2019).

PËRFUNDIME

Kjo ese synon të shtjellojë zhvillimet e fundit në tregjet financiare të Evropës Qendrore dhe Jug-Lindore dhe veçanërisht në Shqipëri, duke analizuar rreziqet dhe mundësitë për sistemin bankar në të ardhmen. Sistemi bankar në rajon dhe në Shqipëri është i mirë-kapitalizuar dhe situata e likuiditetit është e favorshme. Kreditë me probleme kanë treguar një prirje të fortë për poshtë në vitet e fundit, por rigjallërimi i kreditimit dhe përfitueshmëria e sistemit bankar është akoma një sfidë për bankat dhe politikë-bërësit. Në kontekstin e një ngadalësimi ekonomik global, një mjedis i karakterizuar nga norma të ulëta të interesit, ristrukturim të aktiviteteve bankare në nivel global dhe një "bum" teknologjik që pritet të ndryshojë rrënjësisht modelin e biznesit të bankave, e ardhmja e sistemit bankar në rajon dhe në Shqipëri nuk pritet të jetë më e njëjtë.

Për të përforcuar qëndrueshmërinë, politikëbërësit duhet të adresojnë dobësitë financiare që sjellin rreziqe për stabilitetin financiar dhe rritjen ekonomike në periudhën afatmesme. Përgjigjet e duhura të politikës janë domosdosmërisht specifike sipas vendit dhe duhet të marrin parasysh karakterin heterogjen brenda sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe rolin e faktorëve idiosinkratikë dhe institucionalë. Në këtë kontekst, politikëbërësit dhe vendet duhet të zhvillojnë mjedisin e brendshëm ekonomik dhe financiar, dhe nuk duhet të mbështeten vetëm te bashkëpunimi më i fortë mbi rregullimin financiar global. Është gjithashtu e nevojshme të përshpejtohet procesi i reformave strukturore të reja dhe ekzistuese. Në fakt, kjo është e rëndësishme dhe ka për të qenë akoma më thelbësore në të ardhmen duke qenë se një nivel më i lartë integrimi financiar dhe ekonomik zakonisht është i shoqëruar me vulnerabilitet më të lartë ndaj goditjeve të jashtme.

Është e qartë që një nga sfidat kryesore të rajonit EQJL sot është nevoja për të përshpejtuar rritjen e kredisë. Por, është e vështirë në situatën aktuale të shtysh sektorin bankar të lehtësojë kufizimet e kredisë dhe të ofrojë më shumë kredi për ekonominë. Në këto rrethana, bankat jo-BE, subjektet jobanka dhe risitë teknologjike, duke përfshirë Fintech dhe Bigtech kanë potencialin për të ndihmuar. Duke marrë parasysh që ekzistojnë rreziqe që lidhen me pjesëmarrësit e rinj në treg dhe aktorët në përgjithësi, është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi mes vendeve për të minimizuar rreziqet dhe dobësitë. Përveç ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit më të lartë, është thelbësore të mblidhet sa më shumë informacion dhe të dhëna në lidhje me teknologjitë e reja financiare që po riformulojnë tregjet financiare të botës. Këto të dhëna nuk kanë qenë të disponueshme, por janë thelbësore jo vetëm për të kuptuar më mirë, por edhe për të përshtatur ligjet, rregulloret dhe praktikat e mbikëqyrjes me të ardhmen e re. Së fundmi, një përmirësim i edukimit financiar do të ndihmonte si individët, ashtu edhe firmat të krijojnë qëndrueshmëri financiare dhe të zvogëlojnë rreziqet financiare.

REFERENCA

Agénor, Pierre-Richard, and Luiz A. Pereira da Silva. "Global banking, financial spillovers, and macroprudential policy coordination." (2019).

Ahmetaj, Natasha, dhe Hoda, Bledar. "Valutat virtuale, risitë e tyre teknologjike dhe bankingu qëndror", Banka e Shqipërisë, Materiale studimore, 01 (01) 2019, 2019

Amzallag, Adrien, Alessandro Calza, Dimitris Georgarakos, and João Sousa. "Monetary policy transmission to mortgages in a negative interest rate environment." (2019).

Arakelyan, Maria. Foreign banks and credit dynamics in CESEE. International Monetary Fund, 2018.

Nanka e Shqipërisë (BSH), Seria e Raporteve të Politikës Monetare T1/2019-T4/2019, BSH (2019).

Banka e Shqipërisë (BSH), Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes, BSH (2018).

Banka e Shqipërisë (BSH), Seria e Raporteve të Stabilitetit Financiar 6MI/2019-6II/2019, BSH (2019).

Bayoumi, Mr Tamim, Mr Giovanni Dell'Ariccia, Mr Karl Friedrich Habermeier, Mr Tommaso Mancini Griffoli, and Fabián Valencia. Monetary policy in the new normal. International Monetary Fund, 2014.

Beck, Thorsten, and Ross Levine. "Industry growth and capital allocation: does having a market-or bank-based system matter?." Journal of financial economics 64, no. 2 (2002): 147-180.

Beirne, John, Sándor Gardó, and Piotr Zboromirski. "Risks from Euro Area Banks' Emerging Market Exposures." Financial Stability Review 1 (2014).

Benyon, Richard. "Economic transition in the Western Balkans: an assessment." NATO Parliamentary Assembly, Economics and Security Committee. Reference 074 (2017).

BIS (Bank for International Settlements),Annual Economic Report 2018. Basel, Switzerland: BIS (June 2018).

BIS (Bank for International Settlements), Annual Economic Report 2019. Basel, Switzerland: BIS (June 2019).

Blattner, Laura, Luisa Farinha, and Francisca Rebelo. "When losses turn into loans: the cost of undercapitalized banks." (2019).

Borio, Claudio. "On Money, Debt, Trust, and Central Banking." Cato J. 39 (2019): 267. Bredl, Sebastian. "The role of non-performing loans for bank lending rates." (2018).

Budnik, Katarzyna Barbara, Massimiliano Affinito, Gaia Barbic, Saifeddine Ben Hadj, Edouard Chretien, Hans Dewachter, Clara I. Gonzalez et al. "The benefits and costs of adjusting bank capitalisation: evidence from euro area countries." (2019).

CESEE, OF. "Impact of Foreign-Owned Banks on Financial Stability." Foreign-Owned Banks: The Role of Ownership in Post-Communist European Countries (2018): 89.

Constancio, Vitor. "Challenges for the European banking industry." In intervento alla conferenza European Banking Industry: What's Next. 2016.

Covi, Giovanni, Mehmet Gorpe, and Christoffer Kok. "CoMap: mapping contagion in the euro area banking sector." (2019).

Curfman, Christopher J., and John Kandrac. "The costs and benefits of liquidity regulations: Lessons from an idle monetary policy tool." Available at SSRN 3273580 (2018).

Da-Silva, Luiz Awazu Pereira. "Fintech in EMEs: blessing or curse?." In Bank for International Settlement, Panel remarks at CV Meeting of Central Bank Governors of CEMLA-Asuncion, Paraguay. 2018.

Dabrowski, Marek, and Yana Myachenkova. The Western Balkans on the road to the European Union. No. 2018/04. Bruegel Policy Contribution, 2018.

De Haas, Ralph, Yevgeniya Korniyenko, Alexander Pivovarsky, and Teodora Tsankova. "Taming the herd? Foreign banks, the Vienna Initiative and crisis transmission." Journal of Financial Intermediation 24, no. 3 (2015): 325-355.

Demiralp, Selva, Jens Eisenschmidt, and Thomas Vlassopoulos. "Negative interest rates, excess liquidity and retail deposits: Banks' reaction to unconventional monetary policy in the euro area." (2019).

Deuber, Gunter, and Rachel A. Epstein. "Forward-looking implications of the Vienna Initiative: why did Western banks enter the Central, Eastern and Southeastern Europe region, what went wrong and what did we learn?." Ten years of the Vienna Initiative 2009-2019 (2019).

Dore, Timothy, and Traci Mach. "Marketplace lending and consumer credit outcomes: evidence from Prosper." (2019).

Dushku, Elona dhe Kliti Ceca, "Rezultatet e vrojtimit mbi situatën financiare dhe huamarrëse të mikro-bizneseve në Shqipëri" Banka e Shqipërisë, Material Kërkimor 35 (74) (2019)
Dushku, Elona dhe Kliti Ceca, "Rezultatet e vrojtimit mbi situatën financiare dhe huamarrëse të biyneseve bujqësore në Shqipëri" Banka e Shqipërisë, Material Kërkimor 36 (75) (2019)

Eickmeier, Sandra, Benedikt Kolb, and Esteban Prieto. "The macroeconomic effects of bank capital requirement tightenings: Evidence from a narrative approach." (2018).

European Investment Bank. (EIB), CESEE Bank Lending Survey– H2 2013- H2 2019, EIB (2013-2019)

Franch, Fabio, Luca Nocciola, and Dawid Żochowski. "Cross-border effects of prudential regulation: Evidence from the euro area." (2019).

Frost, Jon, Leonardo Gambacorta, Yi Huang, Hyun Song Shin, and Pablo Zbinden. "BigTech and the changing structure of financial intermediation." (2019).

Gächter, Martin, Piotr Macki, Isabella Moder, Éva Katalin Polgár, Li Savelin, and Piotr Żuk. Financial stability assessment of EU candidate and potential candidate countries. No. 190. European Central Bank, 2017.

Gattini, Luca, and Angeliki Zagorisiou. Cross border banking: Pull-push effects of parent banks on subsidiaries' credit extensions. No. 2016/07. EIB Working Papers, 2016.

Hardy, Bryan. "Emerging markets' reliance on foreign bank credit." BIS Quarterly Review, March (2019).

Hauser, Peter, Tatyana Dolgaya, Sorin Revenko, and Michael Kortenbusch. Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries. Country report: FYROM. Regional Studies and Roundtables, 2016.

Hoda, Bledar. "Implikimet e Politikave LS të BQE-së", Banka e Shqipërisë, Seria e Materiale kërkimore, për tu publikuar, 2020

Hoda, Bledar. "Paraja Elektronike dhe Teknologjia Financiare: Një përditësim" Banka e Shqipërisë, Seria e Materialeve Kërkimore, për tu publikuar, 2020

Hughes, Joseph P., Julapa Jagtiani, and Choon-Geol Moon. Consumer lending efficiency: Commercial banks versus a fintech lender. No. 2018-06. Departmental Working Papers, Rutgers University, Department of Economics, 2018.

Jazbec, Bosjan, Cristopher Towe, Marco Pinon, and Biswajit Banerjee. "Reinvigorating Credit Growth in Central, Eastern, and Southern European Economies." (2015).

International Monetary Fund. European Dept., . "3. Banking Challenges in the Western Balkans: Prospects and Challenges". In Regional Economic Outlook, November 2017, Europe : Europe Hitting Its Stride, (USA: International Monetary Fund, 2017).

International Monetary Fund. European Dept., World Economic Outlook, "Global Manufacturing Downturn, Rising Trade Barriers", November 2019, (USA: INTERNATIONAL

Klingen, Christoph, Fabio Mucci, Gunter Deuber, Stefan Kavan, and Märten Ross. Banking in Central and Eastern Europe and Turkey: Challenges and opportunities. Regional Studies and Roundtables, 2013.

Kozarević, Emira, Nedžad Polić, and Amela Perić. "Financial system development progress in Western Balkans." Banks & bank systems 12, № 2 (2017): 7-19.

Martynova, Natalya, Lev Ratnovski, and Razvan Vlahu. "Bank profitability, leverage constraints, and risk-taking." Journal of Financial Intermediation (2019): 100821.

Moder, Isabella, and Niccolò Bonifai. "Access to finance in the Western Balkans." ECB Occasional Paper 197 (2017).

Note, S., and E. Suljoti. "Determinants of the performance of private sector credit in Central and South East Europe." Bank of Albania Report (2012).

Philippon, Thomas, and Ariell Reshef. "An international look at the growth of modern finance." Journal of Economic Perspectives 27, no. 2 (2013): 73-96.

Popov, Alexander. "Evidence on finance and economic growth." In Handbook of Finance and Development. Edward Elgar Publishing, 2018.

Ramon-Ballester, Francisco, Daniela Pulst, Michaela Posch, Li Savelin, Stoyan Manolov, Ivan Huljak, Winona Kuhles et al. "Financial stability challenges in EU candidate and potential candidate countries." (2015).

Sanfey, Peter, and Jakov Milatovic. "The Western Balkans in transition: diagnosing the constraints on the path to a sustainable market economy." European Bank for Reconstruction and Development, Background paper for the Western Balkans Investment Summit hosted by the EBRD 26 (2018).

Sanfey, P., J. Milatović, and A. Krešić. How the Western Balkans can catch up. European Bank for Reconstruction and Development. No. 185. Working Paper, 2016.

Shijaku, Gerti. "Si ndikon konkurrenca në stabilitetit e bankave pas krizave globale në rastin e sistemit bankar shqiptar?" South-Eastern Europe Journal of Economics 15, no. 2 (2017).

Shijaku, Gerti. "Stabiliteti bankar dhe Konkurrenca: Dëshmi nga Tregu Shqiptar Bankar." (2017): 127-154.

Sejko, Gent, dhe Elona Dushku. "Zhvillimi Financiar dhe Rritja Ekonomike – Dëshmi të Reja për Shqipërinë në 'Studime mbi sistemin bankar dhe zhvillimi ekonomik'" 23-48, Banka e Shqipërisë (2018) (vetëm shqip).

Sejko, Gent. "Reformimi i sistemit bankar n; Shqipëri në dritë të Iniciativës së Vjenës." Dhjetë vjet të Iniciativës së Vjenës 2009-2019 (2019).

Sejko, Gent. "Gent Sejko: Zhvillimet ekonomike dhe financiare të Shqipërisë në 2018." (2019).

Sejko, Gent. "Studime mbi sistemin bankar dhe zhvillimi ekonomik", Banka e Shqipërisë (2018) (vetëm shqip).

Suljoti, Erjona, dhe Elona Dushku. "Pasqyrp e performancës Mikro-financiare në vendet EQJL." Asian Journal of Business and Management (ISSN: 2321-2802) 1, no. 03 (2013).

Takáts, Előd, and Judit Temesvary. "How does the interaction of macroprudential and monetary policies affect cross-border bank lending?." (2019).

Unger, Robert. "Revisiting the finance and growth nexus: A deeper look at sectors and instruments." (2018).

Vienna Initiative. "CESEE Deleveraging and Credit Monitor." Quarterly Deleveraging Monitor Q 2 (2018): 2018.

Vienna Initiative. "CESEE Deleveraging and Credit Monitor." Quarterly Deleveraging Monitor Q 3 (2018): 2018.

CIKLET E BIZNESEVE NË OPTIKËN E TREGUESVE TË BESIMIT

Ermelinda Kristo, Rajna Hoxholli, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë, Tetor 2019

ABSTRAKT

Vendimet e konsumatorëve, të ndërmarrjeve dhe të investitorëve mund të ndikohen nga perceptimet e tyre për mjedisin aktual ekonomik dhe nga pritjet e tyre për të ardhmen. Luhatjet në besimin e agjentëve ekonomikë mund të shndërrohen në një burim të pavarur të luhatjeve të cikleve të biznesit. Ky material ka për qëllim të vlerësojë në mënyrë empirike efektet e luhatjeve të besimit në ecurinë e veprimtarisë ekonomike në Shqipëri. Për këtë qëllim, Treguesi i Ndjesisë Ekonomike, një tregues agregat i marrë nga vrojtimet e besimit të biznesit dhe të konsumatorit, është integruar në një model VAR për të shpjeguar rritjen ekonomike. Analiza empirike tregon se besimi është një faktor me ndikim në aktivitetin ekonomik në Shqipëri. Ky ndikim merr një rëndësi më të madhe gjatë episodeve specifike, të cilat përkojnë me luhatje të forta dhe të vazhdueshme të besimit. Analiza konfirmon gjithashtu përcjelljen e goditjeve të besimit nga partnerët tanë tregtarë në besimin në Shqipëri, duke sinjalizuar për mundësinë e ekzistencës së një kanali tjetër të transmetimit të goditjeve nga jashtë.

1. HYRJE

Vendimet e konsumatorëve, të ndërmarrjeve dhe të investitorëve ndikohen, ndër të tjera, nga perceptimet e tyre për mjedisin aktual ekonomik dhe nga pritjet e tyre për të ardhmen. Luhatjet në besim[1], nëpërmjet ndikimit në konsum dhe investime, mund të kthehen në një burim të pavarur të luhatjeve në aktivitetin ekonomik. Ekonomistë të shquar (p.sh. Pigau, Keynes) e kanë njohur këtë rol në studimet e tyre bazë që në fillim të shekullit të 19-të. Që prej asaj kohe, literatura, si ajo teorike dhe ajo empirike, e ka analizuar më tej këtë ide. Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e përqasjeve të ndryshme teorike dhe e mekanizmave kryesorë të transmetimit të goditjeve të besimit në treguesit makroekonomikë gjendet në studimin e Nowzohour dhe Stracca (2017). Në përgjithësi, përqasjet teorike që diskutojnë rolin e besimit në makroekonomi ndahen në dy kategori kryesore: përqasja e "informacionit ose lajmit" dhe ajo e "instinktit veprues (*animal spirit*)". Qasja e parë i lidh luhatjet në besim me informacionin për faktorë themelorë makroekonomikë, aktualë dhe të ardhshëm, si për shembull përmirësime në teknologji. Sipas kësaj qasjeje, goditjet në besim mund të shihen si goditje oferte, dhe si të tilla konsiderohen të kenë ndikim permanent në prodhim. Qasja e dytë, i lidh luhatjet në besim me valë optimizmi dhe pesimizmi në reflektim të pritjeve për zhvillimet

[1] *Në këtë material, termat "ndjesi" dhe "besim" janë përdorur në mënyrë të këmbyeshme.*

ekonomike në të ardhmen; pra, është një lidhje më tepër psikologjike. Sipas kësaj qasjeje, goditjet në besim mund të konsiderohen si goditje kërkese - jo të lidhura domosdoshmërish me faktorët themelorë të ekonomisë - duke pasur kështu një ndikim të përkohshëm në prodhim.

Pavarësisht konsideratave teorike të ndryshme, shumë autorë bien dakord se efekte negative nga goditje në besim në ekonomi, u panë qartë në praktikë gjatë krizës financiare globale, e cila shpesh etiketohet si "kriza e besimit" (p.sh. BQE 2013). Pasojat e saj u ndjenë si në ekonomitë individuale ashtu edhe ndërmjet vendeve, duke ngritur pikëpyetje nëse ka një kanal të besimit për transmetimin e goditjeve. Ekziston një literaturë e gjerë, e cila dokumenton si rolin e besimit në luhatjet e cikleve të biznesit ashtu edhe përcjelljen e goditjeve në besim nga një vend në tjetrin. Ndër studimet më të fundit janë Brzoza-Brzezina dhe Koltowaski (2018), të cilët gjejnë se goditjet e besimit luajnë rol të rëndësishëm në ciklet e biznesit të Polonisë dhe të Eurozonës. Ato gjejnë gjithashtu se goditje të besimit në Eurozonë transmetohen në Poloni dhe shpjegojnë rreth 40% të luajtjeve të ciklit të biznesit të këtij vendi. Aarle dhe Moons (2017) përdorin informacionin e marrë nga treguesit e besimit dhe të pasigurisë për të vlerësuar rolin e tyre në aktivitetin ekonomik në Eurozonë gjatë krizës financiare globale dhe periudhës së rënies ekonomike që pasoi. Ata arrijnë në përfundimin se besimi dhe pasiguria ndikojnë aktivitetin ekonomik. Nowzohour dhe Stracca (2017) kanë analizuar një bazë të dhënash ndërkombëtare të treguesit të ndjesisë ekonomike për 27 vende të zhvilluara dhe kanë gjetur se besimi luan një rol të rëndësishëm në ecurinë e aktivitetit ekonomik. Dees dhe Günter (2014) gjejnë se goditjet në besim shpjegojnë një pjesë të rëndësishme të luhatjeve të ciklit të biznesit për Shtetet e Bashkuara, Eurozonën, Gjermaninë, Francën dhe Italinë, dhe këto goditje kanë natyrë globale.

Ky material ka për qëllim të hulumtojë empirikisht rolin e besimit në shpjegimin e luhatjeve të aktivitetit ekonomik në Shqipëri, si dhe të vlerësojë nëse besimi i agjentëve ekonomikë shqiptarë ndikohet nga besimi në vendet partnere kryesore tregtare. Analiza e ofruar në këtë material ndjek studimet e përmendura më lart dhe përdor si përafrues të besimit në ekonomi tregues të marrë nga vrojtimet. Treguesit e besimit – të ndërtuar mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga vrojtimet e besimit të konsumatorëve dhe të bizneseve – janë një burim informacioni shumë i dobishëm për të zbuluar se cili është mendimi i agjentëve ekonomikë për zhvillimet ekonomike aktuale dhe të ardhshme. Si të tillë, ata mund të ofrojnë informacion unik për shfaqjen e valëve të optimizmit dhe pesimizmit.

Banka e Shqipërisë kryen vrojtime të besimit të konsumatorëve dhe të bizneseve që prej vitit 2002. Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) është treguesi agregat i cili përmbledh mendimin e agjentëve ekonomikë për zhvillimet ekonomike aktuale dhe pritjet e tyre për të ardhmen. Ecuria e tij ndjek relativisht mirë dinamikat e rritjes së prodhimit të brendshëm bruto në terma realë (PBB-së). Kështu, pas gjallërimit ekonomik të periudhës së para-krizës, si TNE-ja ashtu dhe rritja ekonomike filluan një prirje rënëse, duke arritur pikën më të ulët në vitin 2013. Vitet e fundit, të dy treguesit po rikuperojnë dhe TNE-ja qëndron mbi mesataren historike.

Në këtë material, TNE-ja përshihet në një model me vektorë auto-regresivë (VAR) për të shpjeguar rritjen ekonomike në Shqipëri. Përqasja VAR shoqërohet me tre instrumente të dobishme për analizën tonë. Funksionet e reagimit të impulsit dhe dekompozimi i variancës nga modeli VAR përdoren për të studiuar përhapjen e goditjeve të besimit në luhatjet e aktivitetit ekonomik. Krahas tyre, dekompozimi i gabimit të parashikimit historik përdoret për të shqyrtuar si ka evoluar në kohë kontributi i goditjeve në besim në formimin e rritjes ekonomike. Për më tepër, duke përfshirë TNE-në e partnerëve tanë kryesorë tregtarë, përpiqemi të analizojmë nëse ekziston një kanal besimi në transmetimin e goditjeve nga mjedisi i huaj ekonomik në vend.

Analiza e modelit VAR tregon se besimi i agjentëve ekonomikë ndikon luhatjet e aktivitetit ekonomik në Shqipëri. Po ashtu, kjo analizë tregon se goditjet në besim luajtën një rol të veçantë në ngadalësimin ekonomik pas krisës së borxhit të Greqisë dhe të Eurozonës, si dhe në përshpejtimin e rritjes ekonomike në vitet 2016 dhe 2017. Për më shumë, analiza sugjeron se goditjet në besimin e agjentëve ekonomikë në Itali përcillen në besimin e agjentëve ekonomikë në Shqipëri.

Materiali është strukturuar si në vijim. Në pjesën e dytë të tij paraqesim një analizë përshkruese të ecurisë së treguesve të besimit dhe të aktivitetit ekonomik në vend, si dhe korrelacionin midis tyre. Në pjesën e tretë fokusohemi në analizën e sinkronizimit të cikleve të besimit midis Shqipërisë, BE-së dhe vendeve të tjera të rajonit. Pjesa e katërt vlerëson empirikisht rolin e TNE-së në shpjegimin e ecurisë së aktivitetit ekonomik në vend, duke përdorur modelin VAR. Në pjesën e pestë përmblidhen përfundimet kryesore të analizës.

2. TREGUESIT E BESIMIT DHE AKTIVITETI EKONOMIK

Treguesit e vrojtimit të besimit të biznesit dhe të konsumatorit përdoren gjerësisht në literaturë për të shpjeguar dhe për të parashikuar aktivitetin ekonomik, pasi informacioni i marrë nga vrojtimet mblidhet më shpejt në kohë se treguesit sasiorë, si dhe ai gëzon veti paraprijëse. Banka e Shqipërisë nisi të kryejë rregullisht (me frekuencë tremujore) vrojtimet e besimit të konsumatorit dhe bizneseve në fillim të vitit 2002. Informacioni i mbledhur nga vrojtimet e besimit ka pasuruar aparatin analitik dhe instrumentet e parashikimit afatshkurtër të Bankës së Shqipërisë, duke mbështetur në këtë mënyrë vendimmarrjen e politikës monetare. Duke nisur nga muaji maj 2016, vrojtimet e besimit janë harmonizuar plotësisht me metodologjinë e Komisionit Evropian dhe kryhen sipas Programit të Përbashkët të Harmonizuar të BE-së për vrojtimet e Biznesit dhe Konsumatorit (BCS) për vendet anëtare dhe ato kandidate të BE-së[2]. Hapësira Informuese 1 ofron një pamje të përgjithshme të fazave të ndryshme që Banka e Shqipërisë ka kaluar për kryerjen e vrojtimeve të besimit të konsumatorit dhe të biznesit.

[2] *Ky program përfshin 28 vende të Bashkimit Evropian si dhe 5 vende kandidate: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Serbi dhe Turqi. Për informacion të detajuar shih Komisioni Evropian (2019).*

Në këtë material përdoret treguesi i ndjesisë ekonomike, i cili është tregues i përbërë i besimit të agjentëve ekonomikë që veprojnë në sektorët e industrisë, ndërtimit, shërbimeve, tregtisë me pakicë dhe i besimit të konsumatorëve. TNE-ja ndërtohet bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian. Nivelet e TNE-së mbi 100 tregojnë besim/optimizëm mbi mesatare dhe nivelet e TNE-së nën 100 tregojnë besim/pesimizëm poshtë mesatares.

Grafiku 1 tregon ndryshimet vjetore të PBB-së reale dhe TNE (majtas) dhe komponentët përbërës të TNE-së të rishkallëzuar si ndryshim nga mesatarja përkatëse historike (djathtas). Pavarësisht se seritë janë shumë të luhatshme, veçanërisht PBB-ja, të dy treguesit shfaqin dinamika të ngjashme. TNE-ja dhe PBB-ja kanë pasur prirje rritëse gjatë periudhës 2002-2007 në pasqyrim të ecurisë ekonomike pozitive, brenda dhe jashtë vendit dhe euforisë para krizës financiare globale. Më pas, ndikuar nga kriza globale financiare dhe kriza e borxhit grek, TNE-ja dhe rritja e PBB-së kanë pasur tendencë rënëse, duke arritur nivelin më të ulët në vitin 2013. Të dy treguesit ndoqën një përmirësim ciklik, ku TNE-ja qëndron mbi mesataren e saj afatgjatë. Koeficienti i korrelacionit është 0.42 për ndryshime të njëkohshme dhe rritet deri në maksimum prej 0.46 kur TNE-ja lejohet të paraprijë me dy tremujorë rritjen e PBB-së reale.

Grafik 1. TNE dhe rritja e PBB-së (majtas); Treguesit e Besimit (TB) si diferencë nga mesatarja afatgjatë (djathtas).



Përgjithësisht, gjendjet e optimizmit/pesimizmit janë të sinkronizuara ndërmjet sektorëve (treguar në Grafikun 1, djathtas). Treguesit e besimit sektorial qëndrojnë, në përgjithësi, mbi mesataren historike deri në fillim të vitit 2009. Më pas, vëmë re një periudhë të shkurtër ku divergjojnë: nga njëra anë treguesit e besimit të konsumatorit dhe tregtisë kontribuojnë pozitivisht tek TNE-ja; dhe nga ana tjetër besimi në ndërtim, industri dhe shërbime kontribuon negativisht deri në mes të vitit 2011. Kriza globale financiare, së pari, goditi besimin e industrisë, si sektori më i lidhur me kërkesën e huaj. Ai u pasua nga një rënie më e shpejtë dhe persistente e treguesit të besimit në ndërtim dhe shërbime. Pas krizës greke, të gjithë treguesit e besimit ranë poshtë mesatareve historike. Zhvillimet gjatë viteve të fundit janë pozitive, niveli i treguesve të besimit qëndron mbi mesataret përkatëse historike dhe ka ardhur duke u rritur.

Analiza e korrelacionit tregon për një lidhje të ngushtë midis TNE-së dhe rritjes së PBB-së. Është intuitive të pritet një lëvizje e sinkronizuar dhe një zinxhir ndërveprimesh midis tyre. Kështu, në rast të rënies së besimit mund të pritet që konsumatorët të ulin shpenzimet, kompanitë të ndalojnë së investuari dhe së punësuari dhe investitorët të zhvendosen nga aktivet me rrezik në ato më të sigurta. E gjithë kjo, më pas, do të kontribuojë në një rënie të kërkesës agregate dhe të prodhimit dhe në rritje të papunësisë, të cilat, si rrjedhim do të forconin sjelljen pesimiste të agjentëve ekonomikë. Natyra e komplikuar dhe e ndërthurur e lidhjes midis besimit dhe aktivitetit ekonomik justifikon përdorimin e një përqasjeje VAR për të vlerësuar në mënyrë empirike rolin e besimit në ciklin e biznesit. Kjo përqasje diskutohet në pjesën e katërt të materialit.

HAPËSIRË INFORMATIVE 1. KRYEJA E VROJTIMEVE TË BESIMIT TË KONSUMATORIT DHE BIZNESIT NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë nisi të kryejë vrojtimet e para të besimit në fillim të vitit 2002 në bashkëpunim me INSTAT-in. Qëllimi kryesor në atë kohë ishte të mblidhej informacion për zhvillimet ekonomike aktuale dhe të pritshme në periudhën afatshkurtër, në një kohë kur mungonin llogaritë kombëtare tremujore (Çeliku dhe Shtylla, 2007). Të dhënat e llogarive kombëtare tremujore sipas metodologjisë së prodhimit filluan të publikohen nga INSTATi për herë të parë në vitin 2009. INSTATi publikoi të dhëna për prodhimin e brendshëm bruto sipas metodologjisë së shpenzimeve (kërkesa agregate) me frekuencë tremujore në vitin 2015. Gjatë atyre viteve me mbulim të varfër statistikor të ekonomisë reale, informacioni i mbledhur nga vrojtimet e besimit pati vlerë të rëndësishme për të analizuar zhvillimet specifike të sektorëve në raportet periodikë të politikës monetare.

Për sa i përket metodologjisë së kryerjes së vrojtimeve të biznesit, në fillim, Banka e Shqipërisë është asistuar nga ekspertë të IFO-s, Instituti Gjerman për Kërkime Ekonomike. Metodologjia e vrojtimeve të konsumatorit u bazua që në fillim në metodologjinë e Komisionit Evropian (Lama dhe Istrefi, 2007). Periudha kohore e kryerjes së vrojtimeve ishte muaji i fundit i tremujorit të marrë si referencë: mars, qershor, shtator dhe dhjetor. Duke filluar nga viti 2010, metodologjia e vrojtimeve të besimit të bizneseve dhe konsumatorëve u përshtat më shumë me metodologjinë e Komisionit Evropian: iu shtua sektori i tregtisë me pakicë dhe u ndërtuan tregues të rinj të besimit, duke përfshirë treguesin e agreguar të ndjesisë ekonomike, TNE.

Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, vrojtimet e besimit janë plotësisht të harmonizuara me metodologjinë e Komisionit Evropian dhe kryhen sipas programit të Komisionit Evropian për Harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit Konsumator dhe të Biznesit (BCS) për vendet anëtare dhe kandidate të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrja në programin BCS solli ndryshimet e mëposhtme: (i) frekuencë e rritur nga 4 në 12 herë në vit; (ii) periudha krahasuese referencë në pyetjet e konsumatorëve ndryshoi në vjetore nga tremujore; dhe (iii) disa pyetje u hoqën nga pyetësorët për bizneset, duke i thjeshtëzuar ato më shumë.

Vrojtimet e besimit aktualisht organizohen me një kampion prej 1200 biznesesh dhe 1200 individësh. Pyetësorët përmbajnë kryesisht pyetje me zgjedhje (tre alternativa për bizneset dhe pesë për konsumatorët), duke kërkuar opinionin/mendimin e tyre për aspekte të ndryshme ekonomike dhe financiare. Përgjigjet e bizneseve dhe të konsumatorëve kuantifikohen nëpërmjet treguesit të balancës si diferencë midis përqindjeve të alternativave "optimiste" dhe atyre "pesimiste". Balancat më

informuese agregohen në nivel sektorial, duke marrë kështu treguesit e besimit për secilin sektor. Kriteri për të përzgjedhur balancën më informuese është korrelacioni linear më i fortë me një seri referencë, që përfaqëson veprimtarinë ekonomike të një vendi, në rastin tonë, ndryshimet vjetore të PBB-së, me frekuencë tremujore. Në nivelin më të lartë të agregimit, të gjitha balancat e përzgjedhura (13) të përdorura për të ndërtuar TB-të janë standardizuar dhe peshuar për të formuar treguesin e TNE-së, e ngjashme me metodologjinë e Komisionit Evropian. Peshat e sektorëve janë caktuar në bazë të peshës së vlerës së tyre të shtuar ndaj totalit të PBB-së: industria 14.6%, ndërtimi 11.8%, shërbimet 41.5%, tregtia me pakicë 12.1%; dhe sektorit të konsumatorëve i është dhënë një peshë prej 20%.

Tabelë 1. Seritë e balancave të pesë sektorëve të ekonomisë, të përzgjedhur për të ndërtuar TNE- në.

Përbërësit e TNE-së	Fillimet e serisë
Industria	
1. Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar	2002 T2
2. Stoku aktual i produkteve të përfunduara	
3. Kontrata porositëse, aktuale	
Ndërtimi	
4. Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar	2002 T2
5. Kontrata porositëse, aktuale	
Shërbimet	
6. Gjendja/ ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar	2002 T4
7. Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar	
Tregtia	
8. Aktiviteti i biznesit gjatë tre muajve të kaluar	2010 T1
9. Punësimit total, pritje	
Konsumatorët	
10. Situata financiare, pritje	2003 T2
11. Situata e përgjithshme ekonomike, pritje	
12. Blerje të mëdha	
13. Situata aktuale financiare	

Megjithëse frekuenca e kryerjes së vrojtimeve të besimit është mujore, duke filluar nga muaji maj 2016, frekuenca e publikimit të rezultateve (analiza e rezultateve me të fundit dhe seritë kohore) në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe në Raportin e Politikës Monetare është tremujore. Shtimi i vrojtimeve mujore do të konsolidojë vlerësimin teknik të komponentit sezonal, duke na mundësuar të publikojmë treguesit e besimit me frekuencë mujore. Balancat individuale me frekuencë mujore përdoren aktualisht për parashikime afatshkurtra të PBB-së, të konsumit dhe të investimeve private.

3. TREGUESIT E BESIMIT DHE SINKRONIZIMI ME VENDET E TJERA

Në fokus të analizës në këtë pjesë është sinkronizimi i cikleve të biznesit në Shqipëri, me BE-në, disa nga partnerët kryesorë tregtarë dhe disa vende të rajonit. Treguesit e besimit mund të jenë "kandidatë" potencialë shumë të mirë për të analizuar ciklet e biznesit, si alternativë e statistikave sasiore. Ata janë të disponueshëm në kohë më shpejt se të dhënat sasiore, si edhe bazohen në metodologji të ngjashme duke mundësuar krahasimin e drejtpërdrejtë të tyre midis vendeve. Për më tepër, treguesit e besimit nuk kanë nevojë për

manipulim statistikor për të identifikuar ciklin, pasi, nga vetë ndërtimi, ata janë tregues stacionarë, që luhaten rreth nivelit historik. Sinkronizimi i ciklit të besimit ndër vendet e BE-së ka qenë në fokus të studimeve të ndryshme, për shembull Gayer dhe Weiss (2006), Weyerstrass, K. *et al.* (2009) dhe Thomakos dhe Papailias (2014).

Analizën krahasuese do ta nisim me treguesin e ndjesisë ekonomike të BE-së, Italisë dhe Greqisë për shkak të lidhjeve të ngushta tregtare dhe financiare me këto vende. Megjithatë, duke përfituar nga baza e pasur e të dhënave të Komisionit Evropian, analiza do të zgjerohet për të përfshirë gjithashtu vende fqinje të tilla si: Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia[3].

Ecuria e TNE-ve për Shqipërinë dhe vendet e tjera paraqitet vizualisht në Grafikun 2. Ndonëse më e luhatshme, TNE-ja e Shqipërisë shfaq ngjashmëri të ngushta me TNE-në e BE-së dhe me atë të Italisë e Greqisë. Analiza e thjeshtë e koeficientit të korrelacionit tregon një koeficient midis dy vendeve përkatësisht: 0.66 midis TNE-së në Shqipëri dhe Itali; 0.53 midis TNE-së në Shqipëri dhe BE; dhe 0.49 midis TNE-së në Shqipëri dhe Greqi. Në çdo rast, korrelacioni kulmon me një vonesë tremujore: zhvillimet në TNE-në në Shqipëri ndjekin me një tremujor vonesë TNE-në në BE, Itali dhe Greqi.

Në këndvështrimin rajonal, shqyrtimi grafik tregon lëvizje të ngjashme të ciklit të besimit midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. Megjithatë, nisur nga horizonti kohor i shkurtër, nuk mund të arrihen përfundime të qëndrueshme rreth shkallës së sinkronizimit me këto vende, pasi një cikël biznesi i plotë, teorikisht, nuk ka përfunduar ende brenda horizontit të mbuluar nga të dhënat. Gjatë viteve të fundit, besimi i agjentëve ekonomikë në rajon ka pasur tendencë rritëse.

Grafik 2. Zhvillimet e TNE-së në Shqipëri dhe vendet e tjera krahasuese



[3] *Ato janë vende kandidate për në BE për të cilat Komisioni Evropian kryen vrojtime të harmonizuara të besimit. Treguesit e vrojtimit të Maqedonisë së Veriut fillojnë nga viti 2008, ndërsa treguesit e besimit për Malin e Zi dhe Serbinë fillojnë përkatësisht në vitet 2012 dhe 2013. Treguesit e vrojtimeve të marrë nga baza e të dhënave statistikore e Komisionit Evropian janë me frekuencë mujore dhe të rregulluara për sezonalitet. Ne i kemi konvertuar me frekuencë tremujore thjesht duke mesatarizuar vlerat mujore.*

Duke filtruar luhatjet shumë afatshkurtra të serive të TNE-së mund të kemi një panoramë më të mirë të komponentit të tyre ciklik. Grafiku 3, tregon seritë e gjeneruara duke zbatuar filtrin *Hodrick Prescott* me parametrin *lambda* modifikuar në 1. Analiza grafike dhe e korrelacionit konfirmon rezultatet e marra në rastin kur u përdorën të dhëna të pafiltruara. Në këtë rast, koeficientët e korrelacionit janë më të mëdhenj, megjithatë veçoritë paraprijëse nuk ndryshojnë. Ndryshimet në besim në Itali dhe Greqi paraprijnë ato në Shqipëri. Pas krizës së vitit 2008, seritë e filtruara të TNE-së për Shqipërinë tregojnë se magnituda e rënies ishte më e theksuar krahasuar me vendet e tjera.

Grafik 3. Krahasimi i komponentëve ciklikë të serive të TNE-së



**Luhatjet më pak se 1.5 vite janë hequr nga seritë.*

Si ka ndryshuar sinkronizimi i ciklit të besimit gjatë kohës? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ne zbatojmë analizën e korrelacionit të të dhënave origjinale (të papërpunuara). Ne llogarisim koeficientin e korrelacionit midis dy vendeve për një mesatare rrëshqitëse katërvjeçare. Në këtë mënyrë, mund të gjurmojmë ndryshimet e korrelacionit që prej vitit 2006 për BE-në dhe që prej vitit 2012 për Maqedoninë e Veriut[4]. Koeficientët rrëshqitës jepen në Grafikun 4.

Grafik 4. Koeficientët rrëshqitës të korrelacionit midis TNE-së në Shqipëri dhe vendeve të tjera.



**Hapësirat e hijezuara tregojnë periudhën 2011-2013.*

[4] *Për shkak të serive të shkurtra, kjo analizë nuk përfshin Serbinë dhe Malin e Zi.*

Sinkronizimi i ciklit të besimit midis Shqipërisë dhe BE-së është mjaft i lartë gjatë pjesës më të madhe të kohës, me koeficient korrelacioni mbi nivelin 0.5. Megjithatë, një thyerje në sinkronizim mund të dallohet gjatë periudhës 2011-2013, periudhë në të cilën vetia paraprijëse e treguesve të besimit të BE-së ka humbur. E njëjta ecuri vërehet edhe në zhvillimet e TNE-së në Itali dhe Greqi. Me sa duket, ashtu siç tregohet edhe nga zhvillimet e serive të sheshuara në Grafikun 3, besimi i biznesit dhe konsumatorëve në Shqipëri është ndikuar në një shkallë më të vogël nga kriza globale financiare sesa nga kriza e borxhit sovran në Greqi dhe BE. Niveli i besimit ra në nivelin më të ulët në vitin 2013.

Në vitet që pasuan, vërejmë një forcim të shkallës së sinkronizimit të besimit në Shqipëri me vendet e BE-së, deri në vitin 2018. Kohët e fundit, rënia e besimit në BE dhe në Itali dhe luhatshmëria e lartë e TNE-së në Shqipëri kanë shkaktuar një korrelacion më të ulët. Kjo është më e dukshme në lidhjen midis Shqipërisë dhe Italisë. Në të kundërt, sinkronizimi i cikleve të besimit midis Greqisë dhe Shqipërisë ka ardhur në rritje (grafiku poshtë, majtas).

Tabelë 2. Lidhjet midis treguesve të besimit (TB) për Shqipërinë dhe vendet e tjera.

	Industria	Ndërtimi	Shërbimet	Tregtia	Konsumatorët
BE	0.70 (njëkoh.)	0.59 (-4)	0.47 (-1)	0.17(njëkoh.)	0.25 (-2)
Italia	0.79 (njëkoh.)	0.64 (-4)	0.64 (njëkoh.)	0.29(contemp.)	0.16 (-1)
Greqia	0.70 (njëkoh.)	0.61 (-4)	0.57 (-2)	0.26 (-3)	-0,13
Maqedonia e Veriut	0.54 (njëkoh.)	0.48 (contemp.)	0.42 (+2)	0,03	0.63 (njëkoh.)

** Shenja "-" tregon se TB-ja e huaj paraprin TB-në e Shqipërisë, shenja "+" tregon vonesë kohore.*
** Qelizat e hijezuara tregojnë koeficientin më të lartë të korrelacionit ndërmjet sektorëve të vendeve që analizojmë.*

Tabela 2 përmbledh koeficientet e korrelacionit midis komponentëve sektorialë të TNE-së të vendeve të ndryshme. Korrelacioni më i lartë evidentohet në sektorin e industrisë; me koeficientë që variojnë nga niveli minimal prej 0.54 midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, në nivelin maksimal prej 0.79 midis Shqipërisë dhe Italisë. Në të gjitha rastet, korrelacioni është më i lartë për lidhje të njëkohshme. Korrelacione më të larta në sektorin e industrisë mund të shpjegohen nga faktorët të konjuikturës ndërkombëtare që ndikojnë këtë sektor, si për shembull në terma të çmimeve të lëndës së parë, kërkesës globale, etj. Për më shumë, sinkronizimi i lartë i ciklit të besimit të industrisë në Shqipëri me Italinë pasqyron më së shumti peshën e lartë të eksporteve shqiptare të tekstileve dhe këpucëve drejt Italisë.

Besimi në ndërtim dhe shërbime gjithashtu është i lidhur ngushtë me vendet fqinje. Sërish, koeficienti i korrelacionit është i lartë me Italinë. Nga ana tjetër, treguesit e sektorit të shitjeve me pakicë dhe i besimit të konsumatorëve janë më pak të lidhur; një përjashtim është lidhja e lartë e besimit të konsumatorëve midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut[5].

Në përfundim, analiza e korrelacionit tregon një sinkronizim të lartë midis cikleve të besimit të Shqipërisë dhe vendeve fqinje - veçanërisht me Italinë - megjithëse kriza globale shkaktoi një shkëputje të përkohshme. Zhvillimet e cikleve të besimit në BE paraprijnë me një tremujor ciklin e besimit në Shqipëri.

[5] *Koeficienti i korrelacionit për këtë çift është 0.63 dhe lidhja është e njëkohshme.*

Kjo i bën treguesit e besimit më të vlefshëm dhe më të rëndësishëm për t'u monitoruar, pasi ato mund të sinjalizojnë herët në kohë pikat e kthesës në aktivitetin ekonomik.

4. ANALIZË EMPIRIKE PËRMES NJË MODELI VAR

Analiza e deritanishme na motivon të eksplorojmë më tej lidhjen midis besimit dhe aktivitetit ekonomik në Shqipëri. Për këtë qëllim, ne do të testojmë nëse treguesit e besimit – konkretisht, TNE-të ofrojnë informacion shtesë për luhatjet e aktivitetit ekonomik përtej informacionit të përfshirë tashmë në tregues sasiorë. Testimi i kësaj hipoteze do të realizohet nëpërmjet përfshirjes së TNE-së në një model me vektorë auto-regresivë (VAR), i cili do të ndërtohet për të shpjeguar rritjen ekonomike. Përdorimi i një modeli VAR është një qasje e favorshme, e cila përdoret gjerësisht në literaturë, për të analizuar marrëdhënien komplekse dhe të ndërthurur ndërmjet treguesve të besimit dhe atyre makroekonomikë (shih p.sh. Aarle dhe Moons 2017, Mendicino dhe Punzi 2013, Dees dhe Brinca 2011, etj.).

Modeli VAR paraqitet më poshtë:

$$y_t = \sum_{i=1}^{q} A_i y_{t-i} + \mu_i$$

$$y = \begin{pmatrix} Vrojtime \\ Fondamente \end{pmatrix}$$

Ku

Dhe μ_i është vektor i goditjeve ortogonale.

Seti i informacionit përfshin TNE-në, PBB-në reale dhe faktorët përcaktues makroekonomikë, të cilët rezultojnë të kenë fuqi parashikuese për luhatjet e aktivitetit ekonomik në Shqipëri. Këto të fundit përfshijnë kushtet monetare reale dhe rritjen ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian (BE). Kushtet monetare të ekonomisë përfaqësohen nga një indeks, i cili merr në konsideratë dy komponentë, përkatësisht normën e interesit të kredisë dhe kursin e këmbimit[6]. Kursi i këmbimit është ai Eur/Lek. Norma e interesit të kredisë është një normë e përbërë, e llogaritur si një mesatare e ponderuar e normës së interesit për kredinë akorduar në lekë dhe asaj akorduar në euro bazuar me peshat që zë leku dhe euro në kreditimin e sektorit privat (40% lekë dhe 60% euro). Rritja e normave të interesit apo mbiçmimi i monedhës vendase – pra një rritje e indeksit të kushteve monetare – nënkupton kushte monetare më të shtrënguara dhe e anasjella. Për këtë arsye, lidhja e saj me rritjen ekonomike dhe ndjesinë ekonomike duhet të jetë negative.
Treguesit e përshirë në modelin VAR janë stacionar në nivel, me përjashtim

[6] *Këta komponentë dhe peshat e përdorura për ndërtimin e indeksit të kushteve monetare janë marrë nga modeli i parashikimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë. Peshat rezultojnë të jenë secila 50%.*

të PBB-së për Shqipërinë dhe BE-në, të cilat përfshihen si ndryshime vjetore. Modeli vlerësohet me frekuencë tremujore për periudhën 2002:T2- 2019:T2. Vonesa kohore prej 1 tremujori e zgjedhur për këtë model, bazohet tek kriteret e informacionit Akaike dhe Shwarc dhe testeve diagnostikuese të mbetjeve.

Skema e identifikimit sipas Cholesky është zgjedhur për të ortogonalizuar goditjet. Renditja e treguesit të TNE-së në fillim është bërë mbi bazën e kriterit të ekzogjenitetit. Të dhënat e vrojtimit mblidhen në muajin e fundit të tremujorit referues, çka tregon se të anketuarit nuk kanë ende informacion për treguesit sasiorë për atë tremujor. Rrjedhimisht, ne mund të supozojmë se TNE-ja nuk reagon në mënyrë të njëkohshme ndaj goditjeve në tregues të tjerë në sistem. Të njëjtin parim e gjejmë tek Mendicino dhe Punzi (2013). Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e parametrave, kemi ndryshuar renditjen e treguesve, por kjo nuk ka sjellë ndryshime të funksioneve të reagimit të impulsit dhe dekompozimit të variancës.

Më poshtë do të raportojmë rezultatet e funksioneve të reagimit të impulseve (IRF), dekompozimin e variancës dhe dekompozimin e gabimit të parashikimit historik.

Grafiku 5 paraqet reagimin e rritjes reale të PBB-së në vend ndaj një goditjeje në besim. Rezultatet janë në përputhje me intuitën ekonomike, pasi një goditje pozitive në besim ndikon pozitivisht rritjen e PBB-së. Rritja e TNE-së, siç u shpjegua më lart, mund të interpretohet si një përmirësim i perceptimit të agjentëve ekonomikë për ecurinë aktuale dhe të ardhshme të mjedisit ekonomik. Ndikimi i goditjeve pozitive të TNE-së në rritjen ekonomike është i konsiderueshëm në afatin e shkurtër dhe rritja ekonomike rritet menjëherë dhe qëndron në nivele relativisht të larta edhe në tremujorin pasues. Sidoqoftë, pas reagimit fillestar, ndikimi i goditjes së TNE-së në rritjen ekonomike zbehet dhe IRF-të bëhen të parëndësishme në nivelin 90% pas dy tremujorëve. Kjo tregon se efektet e goditjeve të besimit në rritjen e PBB-së reale janë afatshkurtra. Dekompozimi i variancës së PBB-së (e cila nuk paraqitet këtu) tregon se goditjet në besim shpjegojnë rreth 14-15% të variancës së prodhimit gjatë horizontit kohor të 10 tremujorëve.

Grafik 5. Funksionet e reagimit ndaj impulseve të PBB-së reale ndaj inovacionit në besim



Modelin tonë të parë e zgjerojmë, duke përfshirë gjithashtu treguesit e ndjesisë ekonomike të partnerëve tanë tregtarë kryesorë: BE, Italia dhe Greqia. Me përfshirjen e tyre synojmë të kontrollojmë nëse goditjet në besimin e këtyre vendeve transmetohen edhe tek besimi në Shqipëri. Funksionet e reagimit të impulseve të TNE-së në Shqipëri ndaj një goditjeje pozitive në treguesit e besimit jashtë – BE, Itali dhe Greqi – tregojnë për një ndikim pozitiv të tyre në ndjesinë ekonomike në vend. Sidoqoftë, ndikimi është statistikisht i rëndësishëm vetëm për Italinë.

Grafiku 6 paraqet funksionin e reagimit të impulseve të TNE-së në Shqipëri ndaj një goditjeje pozitive të besimit në Itali. Përmirësimi i besimit në Itali nuk transmetohet menjëherë në rritje të TNE-së në Shqipëri. Ndikimi i tij rritet në tremujorët pasues të goditjes, duke kulmuar në tremujorin e tretë. Rezultatet e IRF-ve, sugjerojnë për një kanal të mundshëm 'besimi' për transmetimin e goditjeve nga Italia në Shqipëri. Ato janë në linjë me evidencën e siguruar nga studime të tjera për ekzistencën e një kanali besimi për transmetimin e goditjeve si tek Dées dhe Güntner (2014), Dees dhe Brinca (2011), Fei (2011), etj.

Grafik 6. Funksionet e reagimit ndaj impulseve të besimit vendas ndaj inovacionit të besimit në Itali



Së fundmi, ne përdorim dekompozimin e gabimit të parashikimit historik për të hulumtuar rolin që kanë luajtur goditjet e besimit në ecurinë e rritjes ekonomike në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit.

Grafiku 7 paraqet dekompozimin e rritjes ekonomike sipas dy komponentëve: (i) parashikimit të gjeneruar nga modeli. Me fjalë të tjera, ecurinë e rritjes ekonomike që modeli parashikon mbi bazën e ecurisë së treguesve të përfshirë në të, në kushtet kur nuk ka goditje; dhe (ii) kontributin nga goditjet. Këto të fundit ndahen në dy lloje, në goditje nga faktorët përcaktues makroekonomikë (sasiorë) dhe nga besimi. Grafiku tregon qartë se goditjet në fondamentet ekonomike luajnë një rol më të madh në krahasim me goditjet në besim, në ecurinë e rritjes së PBB-së. Sidoqoftë, mund të vërehet se rëndësia relative e goditjeve në besim rritet gjatë disa periudhave specifike, të cilat korrespondojnë

me episodet e krizave dhe/ose rigjallërimi ekonomik. Në vija të përgjithshme, kontributi i goditjeve në besim në rritjen reale të PBB-së ishte pozitive deri në fillim të vitit 2010, negativ midis viteve 2011 dhe 2014, dhe përsëri pozitiv në 2016-ën dhe 2017-ën. Kriza globale financiare solli një përkeqësim të ndjesisë ekonomike në Shqipëri, siç ilustrohet nga rënia e TNE-së gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, rënia ishte relativisht e butë, duke reflektuar deri diku kohëvonesën e materializimit të efekteve të krizës financiare globale në treguesit makroekonomikë në vend, si dhe stimulin e lartë fiskal që iu ofrua ekonomisë në periudhën e fillimit të krizës dhe gjatë viteve që pasuan.

Kriza greke dhe, më vonë, ajo e borxhit sovran të BE-së identifikohen nga modeli si episode të goditjeve negative të forta dhe të vazhdueshme në besimin e agjentëve ekonomikë. Këto goditje kontribuuan negativisht në rritjen e PBB-së reale gjatë asaj periudhe. Ndjesia ekonomike u bë përsëri një mbështetës i rritjes ekonomike gjatë viteve 2016-2017, në një kohë kur shifrat për rritjen ekonomike brenda dhe jashtë vendit ishin pozitive dhe TNE ishte në nivel të lartë.

Grafik 7. Dekompozimi i gabimeve të parashikimit historik të PBB-së reale



Rëndësia episodike e treguesve të besimit në shpjegimin e luhatjeve të aktivitetit ekonomik mund të sugjerojë për një marrëdhënie jo-lineare midis të dyjave; lidhja midis tyre bëhet më e fortë për ndryshime të mëdha të treguesve të besimit (shih p.sh. Dees dhe Brinca 2011, ECB 2013). Kjo do të nënkuptonte që luhatjet e TNE-së përtej disa niveleve (të cilat mund të quhen kritike) mund të jenë më informuese për rritjen ekonomike në të ardhmen. Në përputhje me metodologjitë e studimeve të lartpërmendura, ne u përpoqëm të vlerësojmë nivelet kritike dhe të gjenerojmë seri alternative të TNE-së, të cilat do të përfshinin vetëm vlera përtej niveleve kritike. Nga krahasimi i IRF-ve, dekompozimit të variancës dhe dekompozimit të gabimit të parashikimit, evidentohet qartë se përfshirja e TNE-ve alternative në modelin për rritjen ekonomike nuk sjell përfitim shtesë në analizë. Nowzohour, Stracca (2017) arrijnë në një përfundim të ngjashëm kur analizojnë rolin e ndjesisë ekonomike tek variablat makroekonomikë dhe financiarë në 27 ekonomi evropiane.

5. PËRFUNDIME

Qëllimi i këtij materiali është të hulumtojë rolin e treguesve të besimit për shpjegimin e luhatjeve të aktivitetit ekonomik në Shqipëri. Pyetja që shtrohet është: A përmbajnë treguesit e besimit informacion shtesë për aktivitetin ekonomik, përtej informacionit të përfshirë tashmë në të dhënat sasiore? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ne ndërtojmë një model VAR i cili shpjegon rritjen ekonomike me faktorë përcaktues makroekonomikë si kushtet monetare dhe aktiviteti ekonomik në BE, por edhe me Treguesin e Ndjesisë Ekonomike. Ky tregues mbledh perceptimet e agjentëve për mjedisin aktual ekonomik dhe pritshmërinë për të ardhmen.

Analiza empirike tregon se luhatjet në besim ndikojnë rritjen ekonomike në Shqipëri, ndonëse ndikimi i tyre është relativisht i vogël dhe jetëshkurtër. Sidoqoftë, kur analizojmë ndikimin relativ të goditjeve të besimit në ecurinë ekonomike në krahasim me fondamentet e tjera ekonomike, gjejmë se goditjet e besimit marrin një rëndësi më të madhe gjatë episodeve specifike. Këto të fundit i korrespondojnë ndryshimeve të mëdha dhe të vazhdueshme të treguesit të besimit.

Analiza krahasuese midis vendeve tregon se ciklet e besimit në Shqipëri dhe në vendet e BE-së kanë ngjashmëri. Mbi këto premisa, ne përpiqemi të vlerësojmë empirikisht nëse goditjet në besim tek partnerët tanë tregtarë përcillen tek ne. Për këtë qëllim, zgjerojmë modelin fillestar me treguesit e ndjesisë ekonomike për BE-në, Italinë dhe Greqinë. Funksionet e reagimit të impulseve tregojnë se besimi në Shqipëri ndikohet prej besimit në këto vende dhe treguesi i ndjesisë ekonomike në vend rritet ndaj një goditjeje pozitive në besimin jashtë. Sidoqoftë, ky ndikim rezulton statistikisht i rëndësishëm vetëm për Italinë.

Analiza e mësipërme konfirmon rëndësinë e besimit si një burim i mundshëm për luhatje të ciklit të biznesit në Shqipëri. Ky konstatim është i rëndësishëm për politikën monetare, pasi sugjeron se ndryshime në ndjesinë ekonomike mund të përdoren për të sinjalizuar dhe për të parashikuar pikat e kthesës në ciklet e biznesit. Ky mund të jetë një drejtim hulumtimi në të ardhmen. Aktualisht, informacioni i mbledhur nga vrojtimet e besimit ka pasuruar aparatin analitik dhe të parashikimit afatshkurtër të Bankës së Shqipërisë, duke mbështetur në këtë mënyrë vendimmarrjen e politikës monetare.

REFERENCES

Aarle, B. and Moons, C. (2017): "Sentiment and uncertainty fluctuations and their effects on the Euro Area business cycle".

Barsky, R. and Sims, E. (2012): "Information, Animal Spirits, and the Meaning of Innovations in Consumer Confidence".

Brzoza-Brzezina, M. and Kotlowski, J. (2018): "International confidence spillovers and business cycles in small open economies", NBP Working Papers 287.

Çeliku, E. and Shtylla, D. (2007): "Business confidence survey: Methodological aspects and economic analysis of the results", Bank of Albania, Research Paper, June 2007.

Dées, S. and Brinca, P.(2011): "Consumer confidence as a predictor of consumption spending – Evidence for the United States and Euro Area", ECB Working Paper Series No 1349, June 2011.

Dées, S. and Güntner, J. (2014): "The International Dimension of Confidence Shocks", ECB, Working Paper Series No 1669, April 2014.

ECB (2013): "Confidence indicators and economic developments", Monthly Bulletin, ECB, pp.45-58, January 2013.

European Commission (2019a): "The Joint Harmonised EU Programme of Business and Consumer Surveys – User Guide", updated January 2019.

European Commission (2019b): "Special topic: A closer look at the BCS data from the Balkan candidate countries", European Business Cycle Indicators, June 2019.

Fei, S. (2011): "The confidence channel for the transmission of shocks", Banque de France, Working Paper No 314.

Gayer, C. and Weiss, P. (2006): "Convergence of business cycles in the Euro Area: Evidence from Survey Data", Applied Economics Quarterly Vol.52. No 3.

Lama, D and Istrefi, K. (2007): "Consumer's confidence and Albanian economy – a new information bridge", Bank of Albania, Research Paper, June 2007.

Mendicino, C. And Punzi, M.T. (2013): "Confidence and economic activity: the case of Portugal".

Nowzohour, L. and Stracca, L. (2017): "More than a feeling: confidence, uncertainty and macroeconomic fluctuations", ECB Working Paper Series No 2100, September 2017.

Thomakos, D. and Papailias, F. (2014): "Out of Sync: The breakdown of economic sentiment cycles in the EU", Review of International Economics, 22(1), 131-150, 2014.

IMPAKTI I FAKTORËVE SEZONALË NË INFLACIONIN E PERIUDHËS 2008-2018 NË SHQIPËRI

Gent Hashorva, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

ABSTRAKT

Artikulli synon të verifikojë hipotezën e pranisë së modifikimeve të rëndësishme të sjelljes sezonale të inflacionit total dhe të grupeve kryesore të tij, në Shqipëri, në kohë dhe në intensitet, për periudhën 2008-2018. Artikulli konkludon se gjatë periudhës në analizë, sjellja sezonale ka pësuar ndryshime në terma të zhvendosjeve kohore dhe të amplitudave që faktorët sezonalë kanë shfaqur. Me gjithë ndryshimet e verifikuara, përcaktuesi kryesor në luhatjet sezonale të inflacionit total, ashtu siç pritej, mbetet kategoria "Ushqime të papërpunuara". Në këtë kontekst, evidentohet rëndësia e njohjes së efekteve të modifikuara sezonale dhe implikimet në inflacionin total.

1. HYRJE

Zbatimi efektiv i strategjisë së shënjestrimit të inflacionit në masë të madhe varet nga njohuritë që zotërojmë për të gjithë faktorët që ndikojnë në vlerën e inflacionit, si një prej treguesve më përfaqësues të ecurisë së çmimeve në ekonomi.

Analiza e ecurisë të serive kohore të inflacionit, vështirësohet nga prania e komponentëve të ndryshëm që ndikojnë në strukturën e serisë kohore. Këto, si rregull, përfshijnë komponentin e trendit, të ciklit, të faktorëve sezonalë, të parregullsive afatshkurtra të shkaktuara nga procese tranzitore dhe të gabimeve që rrjedhin nga procesi i grumbullimit të të dhënave. Ekzistenca e këtyre të fundit jo vetëm vështirëson procesin e analizës, por më tej edhe atë të parashikimit të inflacionit dhe procesin e vendimmarrjes.

Duke marrë parasysh se seria e IÇK-së, përfshin 4 nënkomponentë të sipërpërmendur të rëndësishëm, artikulli është fokusuar veçanërisht tek studimi i sezonalitetit. Ai përpiqet të analizojë strukturën, ecurinë dhe ndikimin e këtij faktori në ecurinë e përgjithshme të IÇK-së. Për të studiuar më mirë burimin e sezonalitetit, artikulli është thelluar në ndikimin e sezonalitetit në disa nga nënkomponentët e IÇK-së.

2. NEVOJA E RREGULLIMIT SEZONAL

Siç u përmend më lart, është e nevojshme të përpunohen të dhënat fillestare para fillimit të analizës së inflacionit dhe faktorëve që kanë ndikuar në formimin e tij. Në këtë proces, disa nënkomponentë të indeksit të çmimeve të konsumit, të tilla si trendi dhe sezonaliteti, duhet të identifikohen për të kryer parashikimin e inflacionit. Një zgjidhje për këtë është dhënë nga llogaritja e inflacionit në terma vjetorë. Norma vjetore, nga mënyra e llogaritjes, eliminon kryesisht trendin dhe sezonalitetin. Prandaj, për qëllime të analizës dhe parashikimit të inflacionit, si edhe komunikimit të politikës monetare, përdoret norma vjetore e inflacionit.

Vendimet e politikës monetare, megjithatë, duhet të bazohen si në seritë kohore që përfshijnë periudha të gjata, ashtu edhe në të dhënat më aktuale. Norma vjetore përfshin një sasi të madhe informacioni nga zhvillimet në 12 muajt e mëparshëm. Por, gjithashtu, lind nevoja që përveç inflacionit vjetor, të analizohen zhvillimet më të fundit ose ngjarjet që kanë ndodhur në 2-3 muajt e fundit. Kjo realizohet nëpërmjet treguesit të inflacionit mujor. Ky i fundit jep një tablo më aktuale dhe më të qartë të inflacionit, nëse pastrohet nga informacioni më pak i rëndësishëm për vendimet e politikës monetare. Në këtë mënyrë, për aq kohë sa analiza e treguesit të inflacionit do të kërkojë të nxirren disa konkluzione lidhur me faktorët që kanë çuar në zhvillimet e çmimeve, është e nevojshme të identifikohen disa luhatje të rregullta të të dhënave, njëra prej të cilave kryhet nëpërmjet procesit statistikor të quajtur "rregullim sezonal".

Rregullimi sezonal është një teknikë statistikore që eliminon ndikimin e sezonit, festave, fillimit të vitit të studimit ose ngjarjeve të tjera që ndodhin rregullisht gjatë një viti në një seri kohore me të dhëna ekonomike. Kjo teknikë mundëson identifikimin dhe analizën e trendeve ciklike dhe komponentëve të tjerë josezonalë në seritë kohore. Duke eliminuar luhatjet sezonale, seritë kohore bëhen më të sheshta nga këndvështrimi i luhatjeve të vlerave, duke lehtësuar kështu analizën e të dhënave me frekuencë të lartë, kryesisht atyre mujore.

Në të njëjtën kohë, qasja ndaj sezonalitetit ka gjithashtu një aspekt të rëndësishëm për komunikimin e politikës monetare. Faktori sezonal i pranishëm në inflacionin mujor, i cili publikohet nga autoriteti statistikor, mund të krijojë pritshmëri të ekzagjeruara ose mjaft më të ulëta të inflacionit. Autoriteti monetar, nëpërmjet vendimeve të tij, shpjegon se shpesh shifra të rëndësishme mujore të çmimeve në kohë të caktuara të vitit janë pasojë e sezonalitetit dhe shuhen në kohë, kur faktori që i ka shkaktuar efektin nuk vepron më me të njëjtin intensitet.

3. NJË VËSHTRIM I SHKURTËR MBI LITERATURËN

Në "*Measuring short-term inflation for central bankers*", Cecchetti (1996) thekson se seria e ndryshimit mujor të IÇK-së përmban kaq shumë luhatje rreth prirjes sa që vlera e shtuar e informacionit të saj për vendimmarrësit është e vogël. Për këtë arsye, ky informacion duhet të përpunohet më tej ose ndryshe të rregullohet.

Bryan dhe Cecchetti (1995) dhe Cecchetti (1996), në studimet e tyre kanë analizuar praninë e sezonalitetit për të dhënat e SHBA-së dhe rëndësinë që ka në analizat ekonomike. Në të njëjtën kohë, ata shpjegojnë vështirësinë në identifikimin e një origjine të lehtë të përcaktimit të luhatshmërisë sezonale të çmimeve. Gjithashtu, ekzistojnë edhe opinione që pretendojnë se informacioni që vjen nga rregullimi sezonal përmban informata të dobishme që duhet të merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve makroekonomike. Edhe pse shumë makroekonomistë janë të mendimit se krijuesit e politikave nuk duhet të ndikohen nga zhvillimet sezonale në mbështetjen e vendimeve, pasi kjo thjeshton punën e tyre kur nuk ka ndërveprim mes cikleve sezonale dhe cikleve të biznesit, ka edhe pikëpamje alternative. J. Miron (1990), shpjegon se luhatjet sezonale përmbajnë informacion të rëndësishëm të ciklit ekonomik dhe mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në pritshmëritë e konsumatorit. Në këtë mënyrë, luhatjet sezonale duhet të trajtohen me kujdes në analizën makroekonomike dhe jo vetëm si një komponent i serisë të të dhënave.

4. TË DHËNAT: RASTI I SHQIPËRISË

Të dhënat mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) u përdorën në studim duke filluar nga janari i 2008-ës deri në dhjetor të 2018-ës. Faktori sezonal u studiua si për IÇK-në, ashtu edhe për kategoritë kryesore të tij të përfshirë në tabelën e mëposhtme (Tabela 1). Kategoritë e përfshira në të cilin janë analizuar faktorët sezonalë përbëjnë më shumë se 90% të strukturës së IÇK-së. Kategoria "mallra me çmime të rregulluara" nuk ndikohet nga luhatjet sezonale.

Tabelë 1. Kategoritë e mallrave dhe shërbimeve në të cilat është ndarë shporta e matjes së IÇK-së

Inflacion total (pesha përkatëse)
1.Ushqime të përpunuara (25.2%)
-Bukë dhe drithëra (6.7%)
-Qumësht, djathë dhe vezë (7%)
2.Ushqime të papërpunuara (16.9%)
-Fruta (3%)
-Zarzavate (5%)
3.Mallra industriale (15.5%)
-Veshje dhe këpucë (3.7%)
-Pajisje shtëpiake (5.8%)
4.Mallra energjitike (4.6%)
-Naftë dhe karburant (3.6%)
5.Shërbime (30.1%)
-Strehim (13.4%)
-Restorante dhe kafe (3.3%)
6.Mallra me çmime të rregulluara (7.7%)
-Pagesa e ujit të pijshëm (1.1%)

Burimi: INSTAT.

Në studim, rregullimi sezonal i serisë së të dhënave dhe përfitimi i faktorëve sezonalë u krye duke përdorur metodën X12-ARIMA[1].

[1] *Referuar praktikës së ndjekur nga Deutsche Bundesbank, (Banka Qendrore e Gjermanisë).*

5. ANALIZË EMPIRIKE E SEZONALITETIT TË INFLACIONIT

Prania e përbërësit sezonal në seritë kohore të inflacionit është një fenomen i zakonshëm si në ekonomitë e zhvilluara, edhe në ato në zhvillim. Luhatjet thuajse të rregullta të çmimeve, të disa prej mallrave ushqimore, joushqimore apo edhe të shërbimeve, brenda periudhave apo muajve të caktuar dhe për disa vite radhazi, krijojnë profilin sezonal të inflacionit total.

Në ekonomitë në zhvillim, me profil të rëndësishëm prodhimi dhe konsumi drejt mallrave agro-industriale, sezonaliteti në inflacion do të shkaktohej më së shumti nga luhatjet e rregullta stinore në çmimet e ushqimeve. Disa nga faktorët që drejtojnë sjelljen sezonale në këto çmime janë: sezonaliteti në prodhimin bujqësor; sezonaliteti në kërkesë dhe në sjelljen konsumatore; kushtet e zakonshme stinore të motit etj. (Kaminski *et al.*, 2014). Duke iu referuar rastit të Shqipërisë, nga analiza e komponentëve kryesorë të IÇK-së (Grafik 1), vërehet se luhatjet më të larta sezonale ndodhin në çmimet e ushqimeve, për më tepër atyre të papërpunuara (Çeliku, 2015). Faktorët sezonalë të tre komponentëve të tjerë të IÇK-së kanë një ndikim dukshëm më të ulët në faktorin total sezonal.

Grafik 1. Ecuria e normës mujore të inflacionit dhe e komponentëve përbërës së saj



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Në muajt e parë të vitit, faktori sezonal ka një madhësi të moderuar pozitive, e cila kulmon në muajin shkurt (Grafik 2). Në mars, ndikimi sezonal është lehtësisht pozitiv, ndërkohë që në muajin prill faktori sezonal bëhet negativ për të vazhduar kështu deri në muajin korrik. Muaji maj shënon dhe intensitetin më të lartë të vlerave negative të koeficientëve. Nga gushti, faktori sezonal rikthehet në territorin pozitiv dhe rezulton me vlera pozitive edhe në muajin shtator, megjithëse me intensitet më të ulët. Në dy muajt pasardhës, tetor e nëntor, luhatjet sezonale karakterizohen nga vlera të moderuara negative. Ecuria e faktorit sezonal gjatë vitit kulmon me muajin dhjetor, gjatë të cilit intensiteti i tij pëson një rritje të ndjeshme në javën e fundit të këtij muaji.

Grafik 2. Ecuria mujore e koeficientëve sezonalë të inflacionit total për periudhën 2008-2018



Burimi: Vlerësime të autorit.

Shpesh sezonaliteti përbën elementin përcaktues të luhatjeve të inflacionit total. Nëse intensiteti i faktorëve sezonalë në inflacion mbetet thuajse i pandryshueshëm brenda viteve për periudha të gjata kohore, parashikimi i luhatjeve të inflacionit do të ishte relativisht i saktë. Më konkretisht, zhvillimet në inflacion në Shqipëri, rajon dhe më gjerë, kanë treguar se faktorët sezonalë në inflacion mund të mbeten të rëndësishëm duke ruajtur drejtimin e luhatjes (rritje/ulje), por në kohë ata mund të humbasin apo fitojnë kontribut në luhatjet e inflacionit. Megjithatë, analiza e faktorit sezonal për periudhën në studim konfirmon faktin se në serinë e IÇK-së ndodhin herë pas here ngjarje jo të rregullta brenda vitit, duke shkaktuar luhatje surprizë në këtë seri dhe si rrjedhim edhe në normën e inflacionit. Këto ngjarje "surprizë" janë shkaktuar në pjesën më të madhe nga çmimet e ushqimeve (rreth 40% e shportës) dhe më konkretisht nga ato të papërpunuara. Një arsye më shumë që e bën të nevojshëm studimin e këtyre luhatjeve të profilit sezonal në rastin tonë, është esha relativisht e lartë që këto produkte kanë pasur në shportat me të cilat matet IÇK-ja. Kjo bën që edhe transformime jo shumë të mëdha të sjelljes sezonale në çmimet e prodhimeve bujqësore të freskëta, t'u përgjigjen efekte të konsiderueshme në inflacion.

Në përgjithësi, luhatjet e normës së inflacionit të grupit ushqimor të mallrave kryesisht të formuara nga sjellja sezonale e çmimeve të saj, kanë dhënë nga ana tjetër një kontribut dukshëm pozitiv në periudhën në studim (2008:M1-2017:M12), duke qenë përcaktues në formimin e shifrës së inflacionit. Kështu, nëse norma mesatare vjetore e inflacionit në këtë periudhë kohore ka qenë 2.3%, kontributi i këtij grupi në inflacion ka formuar rreth 75% (ose 1.7 pikë përqindje) të kësaj norme. Ndërkohë, kontributi i kategorive të tjera, që përfshijnë mallrat joushqimore pas një periudhe kohe (2008:M1-2013:M01), në të cilën kontributi i tyre te inflacioni total shënonte vlera të rëndësishme (rreth 1 pikë përqindje mesatarisht) filloi të shënojë vlera më minimale (0.1 pikë përqindje kontribut mesatar te norma e inflacionit) dhe në shumë periudha kohore edhe negative (2013:M2-2013:M08), (2015:M8-2016:M05). Por, në dallim nga grupi i mallrave ushqimore të papërpunuara, çmimet e grupeve

të tjera të mallrave dhe të shërbimeve janë ndikuar në të shumtën nga faktorë të cilët nuk kanë natyrë sezonale.

Kështu, pas vitit 2013, rënia e kontributit të tyre në inflacion, ka të bëjë me faktorë, të cilët përcaktojnë çmimet e disa nga mallrave të rëndësishme dhe me peshë në shportën inflacioniste, ku për t'u përmendur është çmimi i naftës dhe karburanteve. Gjithashtu, që prej vitit 2011 nuk është regjistruar rritje e çmimeve për shkak të rritjes së ndonjë prej çmimeve të rregulluara. Ndërkohë që para vitit 2013, këto ishin fenomene të shpeshta.

Grafik 3. Kontributet në inflacionin total sipas tre grupeve kryesore (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të autorit.

Zhvillimet e mësipërme në inflacionin në Shqipëri tregojnë se faktorët sezonalë mbeten të rëndësishëm, duke ruajtur drejtimin e luhatjes (rritje/ulje), por në kohë ata mund të humbasin apo fitojnë në intensitet. Ndryshimet në sezonalitet janë shkaktuar nga: ngjarje surprizë të motit; përfshirja e politikave të marketingut dhe ndryshimi i sjelljes së fermerëve në tregtim; diferencat në kostot e transaksioneve dhe të transportit; ndryshimet në strukturën e tregjeve; kufizimet financiare (mungesë likuiditeti/ mbështetje e ulët me kredi); shkalla e investimeve në bujqësi; rritja e produktivitetit nëpërmjet metodave intensifikuese; krijimi i sipërfaqeve të serave që mundësojnë prodhime bujqësore të çdo sezoni përgjatë vitit; shkalla e integrimit të tregjeve; nënshkrimi i marrëveshjeve doganore, aplikimi i lehtësirave/barrierave ndërkufitare, faktorë që kanë ndikuar aktivitetin e import-eksporteve të prodhimeve bujqësore të freskëta dhe për rrjedhojë edhe çmimet e tyre.

Për shkak të kombinimit të faktorëve të mësipërm, në rastin e Shqipërisë, sjellja sezonale "është shformuar" në disa periudha. Vlerësimet tregojnë se ka ndryshuar intensiteti i faktorëvë sezonalë sipas periudhave të caktuara, kanë ndodhur zhvendosje në kohë të sezonalitetit dhe në muaj të caktuar të ndonjë viti të caktuar ka ndryshuar kahu i veprimit të faktorëve sezonalë. Disa nga rastet kur çmimet e mallrave ushqimore të papërpunuara janë luhatur ndjeshëm nga sjellja e tyre sezonale janë: vlera historike minimale dhe negative të kontributit në 2011: M12- 2012:M03, e cila kulmoi në muajin

shkurt me një kontribut negativ prej 1 pikë përqindjeje te norma e inflacionit (0.6 pikë përqindje). Periudha 2015:M2 – 2015:M4, karakterizohet nga rritje persistente e kontributit të grupit ushqimor në inflacion, duke kulmuar me muajin prill (kontributi i këtij grupi 2.3 pikë përqindje, inflacioni total 2.3%.). Kjo ka rritur pasiguritë në parashikueshmëri dhe në formimin e pritjeve në terma afatshkurtër të inflacionit total dhe veçanërisht të atij të ushqimeve të papërpunuara.

Në mënyrë të përmbledhur, në Tabelën 2 paraqiten faktorët sezonalë të ndarë sipas dy nënperiudhave kohore M01:08-M12:12 dhe M01:13 – M12:18:

Tabelë 2. Vlerësimi i faktorëve sezonalë të inflacionit të ushqimeve të papërpunuara: 2008: M1- 2018: M12

Muajt	Faktorët sezonalë për periudhën totale dhe sipas 2 nënperiudhave			
	Nënperiudha e parë M01:08-M12:12	Nënperiudha e dytë M01:13 – M12:18	Periudha e plotë: M01:08- M12:18	Ndryshimet në sjelljet sezonale
1	2.51	4.82	3.77	Forcim i faktorit (+)
2	3.63	5.37	4.58	Forcim i faktorit (+)
3	0.79	1.19	0.98	Forcim i faktorit (+)
4	-1.93	-2.37	-2.17	Forcim i faktorit (-)
5	-4.89	-5.85	-5.33	Sezonalitet i lartë dhe forcim i faktorit (-)
6	-4.15	–3.09	-3.57	Sezonalitet i lartë dhe dobësim i faktorit (-)
7	-2.96	-2.23	-2.56	Sezonalitet i lartë dhe dobësim i faktorit (-)
8	1.27	1.41	1.35	Forcim i faktorit (+)
9	1.31	0.60	0.92	Dobësim i faktorit (+)
10	-0.22	-1.32	-0.82	Forcim i faktorit (-)
11	-0.68	-2.24	-1.53	Forcim i faktorit (-)
12	4.80	3.34	4.00	Sezonalitet i lartë dhe dobësim i faktorit (+)

Burimi: Vlerësime të autorit.

Vlerësimi empirik i rëndësisë së faktorëve sezonalë për kategorinë e ushqimeve të papërpunuara tregon se thuajse i gjithë viti, karakterizohet nga luhatje statistikisht të rëndësishme sezonale, me përjashtim të muajve janar dhe shtator. Para vitit 2008, faktorët sezonalë ishin më të përqendruar në muaj të caktuar të tij (maj, korrik dhe dhjetor) dhe me amplituda më të larta. Ndërkohë që futja e prodhimeve të serave dhe përmirësimet në rrjet, ruajtjen, shpërndarjen dhe tregtimin e këtyre produkteve, ka ndikuar në rishpërndarjen e efekteve sezonale përgjatë vitit (Tabela 3).

Tabelë 3. Rezultate të regresit me variablat sezonalë për inflacionin mujor të ushqimeve të papërpunuara: 2008 – 2018

Dependent Variable: DLOG(CPI_ Unprocessed foods)				
Method: Least Squares				
Sample (adjusted): 2008M01 2018M10				
Included observations: 130 after adjustments				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.050300	0.006523	7.711702	0.0000
@SEAS(3)	-0.029581	0.011297	-2.618394	0.0100
@SEAS(4)	-0.083425	0.011297	-7.384436	0.0000
@SEAS(5)	-0.143987	0.011297	-12.74516	0.0000
@SEAS(6)	-0.108287	0.011297	-9.585129	0.0000
@SEAS(7)	-0.092471	0.011297	-8.185103	0.0000
@SEAS(12)	0.040385	0.011668	3.461222	0.0007
@SEAS(10)	-0.057823	0.011297	-5.118275	0.0000
@SEAS(11)	-0.069420	0.011668	-5.949613	0.0000
@SEAS(8)	-0.020413	0.011297	-1.806862	0.0733
@SEAS(2)	0.040329	0.011297	3.569768	0.0005
R-squared	0.785291		Mean dependent var	0.006126
Adjusted R-squared	0.767248		S.D. dependent var	0.063414
S.E. of regression	0.030594		Akaike info criterion	-4.055235
Sum squared resid	0.111380		Schwarz criterion	-3.812598
Log likelihood	274.5903		Hannan-Quinn criter.	-3.956644
F-statistic	43.52374		Durbin-Watson stat	1.850796
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Vlerësime të autorit.

Ndërkohë sezonaliteti i kategorisë së mësipërme, duket se ka prekur në mënyrë të rëndësishme inflacionin total mujor, vetëm në 5 muaj të vitit. Me ulje gjatë muajve maj, qershor dhe korrik dhe me rritje, në muajt shkurt dhe dhjetor, por me zbutje të ndikimeve përkatëse (Tabelë 4).

Tabelë 4. Rezultate të regresit me variablat sezonalë për inflacionin total: 2008 - 2018

Dependent Variable: DLOG(CPI,0,1)				
Method: ARMA Maximum Likelihood (BFGS)				
Sample: 2008M01 2018M06				
Included observations: 126				
Convergence achieved after 3 iterations				
Coefficient covariance computed using outer product of gradients				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.001836	0.000763	2.406279	0.0177
@SEAS(5)	-0.011275	0.001640	-6.874853	0.0000
@SEAS(6)	-0.009895	0.001715	-5.770512	0.0000
@SEAS(7)	-0.006733	0.002372	-2.838885	0.0053
@SEAS(12)	0.009507	0.001846	5.150150	0.0000
@SEAS(2)	0.010855	0.001527	7.108105	0.0000
MA(12)	0.364546	0.094697	3.849606	0.0002
SIGMASQ	1.62E-05	2.22E-06	7.315489	0.0000
R-squared	0.749955		Mean dependent var	0.001780
Adjusted R-squared	0.732858		S.D. dependent var	0.008086
S.E. of regression	0.004179		Akaike info criterion	-8.034929
Sum squared resid	0.002044		Schwarz criterion	-7.832337
Log likelihood	515.2005		Hannan-Quinn criter.	-7.952622
F-statistic	43.86444		Durbin-Watson stat	2.180273
Prob(F-statistic)	0.000000			
Inverted MA Roots	.89+.24i	.89-.24i	.65+.65i	.65-.65i
	.24+.89i	.24-.89i	-.24-.89i	-.24+.89i
	-.65+.65i	-.65+.65i	-.89+.24i	-.89-.24i

Burimi: Vlerësime të autorit.

Si përfundim, dobësimi i faktorit sezonal për disa nga muajt me sezonalitet të lartë i kombinuar me kontributin më të ulët nga grupet e mallrave dhe shërbimeve joushqimore rezulton si një nga faktorët përcaktues që norma e inflacionit në pesë vitet e fundit të mbetet poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

KONKLUZIONE

Zbatimi i strategjisë së shënjestrimit të inflacionit është kryesisht i kushtëzuar nga llogaritja e një treguesi efektiv që do të përfaqësonte ecurinë e inflacionit. Me qëllim formulimin dhe zbatimin e politikës monetare, zakonisht përdoret indeksi i çmimeve të konsumit.

Ndryshimi mujor i indeksit përfshin disa nënkomponentë që nuk janë kaq të rëndësishëm për të analizuar procesin inflacionist dhe për të mbështetur vendimet e politikës monetare. Në këtë drejtim, shumica e studiuesve konfirmojnë se luhatjet sezonale nuk duhet të merren parasysh në vendimet e politikës monetare. Megjithatë, ekzistojnë gjithashtu pikëpamje të ndryshme që argumentojnë se ciklet sezonale mund të ndërveprojnë me ciklet ekonomike dhe madje të kenë një ndikim të caktuar te konsumatori, gjë që do të motivonte shqyrtimin e tyre në procesin e vendimmarrjes.

Studimi u përqendrua në luhatjet sezonale të çmimeve në ekonominë shqiptare për të parë se cila është origjina e tyre, por gjithashtu për të lehtësuar analizën e inflacionit. Indeksi i Çmimeve të Konsumit dhe kategoritë kryesore të mallrave dhe shërbimeve u rregulluan sezonalisht për të analizuar madhësinë dhe evoluimin e faktorit sezonal gjatë një viti. Kështu, studimi gjeti se ndikimi më i madh në luhatjet sezonale përcaktohet nga faktori sezonal i çmimeve të ushqimeve, veçanërisht të papërpunuara. Duke ndjekur luhatjet sezonale të këtyre të fundit, faktori i përgjithshëm sezonal i serisë ka vlera pozitive të moderuara në dy muajt e parë të vitit. Më pas, faktori sezonal bëhet negativ përgjatë muajve të verës. Në gusht e shtator, faktori sezonal kthehet në territorin pozitiv, por sezonaliteti në këto muaj nuk është shumë i qartë. Vlerat negative rikthehen në muajt tetor e nëntor. Muaji dhjetor, në konceptin e konsumatorit, përfaqëson dhe muajin ku sezonaliteti i çmimeve në rritje ka qenë më i evidentuar.

Studimi arrin në konkluzionin se në periudhën 2008- 2018, duke përjashtuar periudha të shkurtra kohore, kahu i luhatjes të faktorëve sezonalë të muajve brenda vitit nuk ka ndryshuar. Nga ana tjetër, intensiteti i këtyre faktorëve pas vitit 2013 ka ndryshuar, në mënyrë të veçantë në muajt me sezonalitet të lartë. Kështu, muajt maj, qershor, korrik dhe në mënyrë të veçantë dhjetor kanë zbehur intensitetin e faktorit sezonal. Pasojat e kësaj janë të drejtpërdrejta në normën e inflacionit. Në kushtet kur kontributi i ushqimeve te norma e inflacionit fillon të pësojë rënie, për peshën që ky grup ka në shportën inflacioniste (ndër vite përbën rreth 40% të shportës), edhe norma e inflacionit do të pësojë atë rënie, çka është vërtetuar në vitet e fundit. Gjatë kësaj periudhe, në kushtet kur edhe kontributi i kategorive të mallrave dhe shërbimeve joushqimore ka pësuar gjithashtu rënie, kjo normë ka qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

LITERATURA

Deutsche Bundesbank, September 1999, "The changeover from the seasonal adjustment method Census X-11 to Census X-12-ARIMA", Monthly Report.

Evelina Çeliku, maj 2015, Hapësirë informuese: "Transformime të sjelljes sezonale të inflacionit: implikime për analizën dhe parashikimi", Raporti i politikës monetare.
Jeffrey A. Miron, 1990, "The economics of seasonal cycles", National bureau of Economic Research WP nr. 3522.

J. Kaminski, L. Christiaensen, C. Gilbert, and C. Udry, 2014, "Seasonality in local food markets and household consumption in and household consumption in Africa", IMF-OCP-NYU Conference.

Michael F. Bryan, Stephen G. Cecchetti, 1995, "The seasonality of consumer prices", National Bureau of Economic Research WP nr. 5173.

Stephen G. Cecchetti, 1996, "Measuring short-run inflation for central bankers", National Bureau of Economic Research WP nr. 5786.

SFIDAT E EKONOMISË SHQIPTARE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM AFATGJATË

Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Shqipëria nisi rrugëtimin e ndryshimit të madh shumëdimensional të saj në vitet 1990, si një vend i ri, energjik dhe i gatshëm të ndërtojë ekonominë duke u mbështetur në tregun e lirë. Vendi po fillonte nga *tabula rasa*. Institucionet nisën të riorganizohen si në jetën politike ashtu dhe ekonomike, duke ndërmarrë një sërë reformash: e drejta e pronës; infrastruktura; ndërmjetësimi financiar; taksimi; liberalizimi i çmimeve etj., ishin disa nga reformat më të domosdoshme. Një nga sfidat kryesore për vendin ishte zvogëlimi i rolit të shtetit në ekonomi, që kërkonte ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore. Fillimisht, përpjekjet për privatizimin u përqendruan në njësitë e vogla deri në dhjetë punëtorë, ndërsa strategjia afatmesme synonte nxitjen e sipërmarrjeve private në agrikulturë, industri dhe shërbime.

Të njëjtat reforma prekën shumë shpejt edhe sektorin bankar të përbërë nga tre banka shtetërore, ineficienca e të cilave në aktivitetin e kreditimit i çoi eventualisht në faliment disa vite më vonë. Në një mjedis të tillë, një rrjet financiar privat joformal, që më vonë u kthye në skemë piramidale, u zhvillua me shpejtësi, duke financuar sektorin privat, por me kosto shumë të lartë. Për këto arsye, strategjia afatmesme e zhvillimit të sektorit bankar në mesin e viteve 1990 kishte për qëllim: lejimin e hapjes të bankave private të prirura sipas parimeve të tregut; forcimin e kuadrit ligjor për të mbikëqyrur sistemin financiar; dhe zhvillimin e infrastrukturës bankare.

Një transformim i madh ndodhi në strukturën e ekonomisë në dekadën e parë të tranzicionit, ku shpërndarja e burimeve u zhvendos nga industria dhe bujqësia, tek shërbimet dhe ndërtimi. Ndryshimet më të ndjeshme u regjistruan në tkurrjen e kontributit të industrisë në prodhimin e brendshëm bruto nga 39% në vitin 1990 në më pak se 8% në vitin 2000, ndërsa kontributi i shërbimeve u zgjerua nga 33 në mbi 58%. Ndërtimi shënoi gjithashtu një bum drastik nga 3% e PBB-së në fillim të viteve 1990, në gati 12% të PBB-së në 2002. Nga ana tjetër, rëndësia e bujqësisë u reduktua me mbi 10 pikë përqindje të PBB-së, pas peshës prej gati një-të-tretën e ekonomisë që ajo zinte në vitet 1993-96. Ky transformim i madh strukturor në drejtim të sektorëve më produktivë u shoqërua me një tkurrje drastike të rolit të shtetit në ekonomi në një peshë prej vetëm 25% në vitin 2002.

Politikat ekonomike në dhjetëvjeçarin e dytë synonin rritjen e qëndrueshme, të mbështetur në faktorët realë dhe jo më nga ndihmat e huaja. Përmirësimet ishin të dukshme në mjedisin e biznesit, të energjisë, në sektorin financiar, administrimin tatimor dhe në administrimin e financave publike, të cilat çuan në zhvendosjen e fuqisë punëtore në drejtim të sektorëve me rendiment më të lartë. Gjithashtu, integrimi ekonomik dhe financiar i Shqipërisë u rrit ndjeshëm

deri në vitin 2008. Tregtia me jashtë u dyfishua në 85% të PBB-së, ndërkohë që kapitali dhe investimet e huaja u trefishuan në mbi 82% të prodhimit. Ndërkaq, tregues të ndryshëm evidentonin se stabiliteti makroekonomik i kësaj periudhe ndikoi në uljen e ndjeshme të varfërisë në Shqipëri, ku numri i personave në vështirësi për plotësimin e nevojave më elementare të ushqimit zbriti në 1.2% në 2008.

Politikat e kujdesshme fiskale dhe monetare mundësuan gjithashtu rritjen e shpejtë të sistemit bankar. Privatizimet e bankave më të mëdha shtetërore në vitet 2001 dhe 2004 i dhanë shtysë disa ndryshimeve pozitive në këtë sektor. Depërtimi i bankave në ekonomi ishte i shpejtë, duke zgjeruar kreditimin bankar nga më pak se 5% e PBB-së në vitin 2001, në rreth 37% në 2009. Ndërkohë, reformat e kujdesshme dhe masat e marra nga Banka e Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar që pas rënies së skemave piramidale kishin dhënë frytet e tyre. Në një kohë kur ekonomia globale përfshirë rajonin tonë po vuanin pasojat e recesionit të madh në vendet e zhvilluara gjatë 2008-2009, sistemi financiar shqiptar provoi se ishte relativisht i shëndetshëm që i rezistoi edhe një stresi të përmasave të mëdha.

Impakti i krizës globale dhe sfidat në të ardhmen

Thellimi i krizës globale në vitin 2009 dhe problemet ekonomiko-financiare më pas në Eurozonë patën ndikim të ndjeshëm edhe në Shqipëri, duke vënë në provë modelin e rritjes ekonomike të mbështetur ndër të tjera nga rritja e vrullshme e kredisë bankare. Ritmi i rritjes ekonomike thuajse u përgjysmua gjatë viteve 2009-14, i ndikuar më së shumti nga rënia e prodhimit potencial të vendit. Statistikat kombëtare evidentojnë një tkurrje të ndjeshme të kontributit të ndërtimit dhe të shërbimeve në periudhën e paskrizës, ndërsa vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare sugjerojnë se rënia e kontributit të kapitalit, sidomos e atij njerëzor, shpjegon rritjen e ngadaltë gjatë viteve 2010-15 në krahasim me vendet e rajonit.

Megjithatë, në vitet e fundit, Shqipëria ka përjetuar normat më të larta të rritjes ekonomike për thuajse një dekadë, duke krijuar shpresën se më e keqja ka kaluar. Në të vërtetë, perspektiva e rritjes ekonomike në periudhën afatmesme, sipas institucioneve vendase ashtu dhe atyre ndërkombëtare prestigjioze, është përgjithësisht e favorshme. Vlerësimet për vitet e ardhshme sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të tentojë të arrijë nivelet potenciale, i nxitur më së shumti nga konsumi dhe investimet në ekonomi. Pritshmëritë tregojnë se kërkesa për ndërtime të reja dhe investimet në këtë sektor do të vijojnë në periudhën afatmesme, edhe për shkak të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i madh në nëntorin e kaluar. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e kursimeve do të vazhdojnë të alokohen në ndërtim, duke frenuar deri diku potencialin e investimit në fusha të tjera të prodhimit që mund të siguronin një rritje të qëndrueshme të ekonomisë sonë në të ardhmen.

Të projektosh të ardhmen është në thelb e pamundur, megjithatë kjo nuk na pengon të bëjmë parashikime se ç'mund të ndodhë e të përgatitemi për to. Vitet e fundit kanë renditur një numër të gjatë sfidash për politikë-bërësit në Evropë. Konflikti tregtar mes ekonomive më të fuqishme të botës, pasiguria e lidhur me daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, shqetësimet e vendeve të zhvilluara mbi emigracionin, polarizimi ekonomik në Evropë dhe brishtësia ekonomike-financiare në disa vende anëtare të BE, etj., kanë rritur skepticizmin e përgjithshëm mbi përfitimet nga globalizmi, ndërsa kanë vënë në diskutim edhe rendin e tanishëm politik e ekonomik. Zgjidhja që do të marrin këto çështje në ekonomitë e mëdha pritet të formësojnë edhe panoramën e zhvillimeve në Evropën Juglindore ku ne ndodhemi.

Deri tani, raportet ekonomike tregojnë se investimet e huaja, shumë të rëndësishme për zhvillimin e rajonit tonë, mbeten përgjithësisht të kënaqshme pavarësisht rritjes së ulët ekonomike në Eurozonë. Megjithatë, aktiviteti i lëkundur ekonomik në Eurozonë dhe më gjerë mund të ulë entuziazmin për investimet e huaja *greenfield* në të ardhmen. Atraksioni i investimeve të huaja dhe rritja ekonomike në të ardhmen do të varet nga aftësia e ekonomisë për të zvogëluar hendekun e krijuar. Prandaj, prioritizimi i "faktorëve plotësues të prodhimit" është i domosdoshëm për mbështetjen e rritjes së shpejtë ekonomike. Diskutimi se cilët sektorë të ekonomisë (si bujqësia, turizmi, industria, etj.) duhet të zhvillohen për të nxitur rritjen ekonomike në të ardhmen është përtej qëllimit të këtij artikulli. Por ajo që duhet theksuar është se shteti me të gjithë mekanizmat e tij mund të luajë një rol lehtësues në këtë proces, duke përmirësuar klimën e biznesit për lulëzimin e firmave private.

Për më tepër, kufizimet më të mëdha për rritjen e mëtejshme të ekonomisë shqiptare duket se do të vijnë nga pamjaftueshmëria e kapitalit njerëzor dhe e një infrastrukture më të sofistikuar. Pritshmëritë për një tkurrje të ndjeshme demografike në një të ardhme jo të largët ngrenë shumë pikëpyetje mbi mundësitë e rritjes ekonomike. Për këtë nevojitet një rritje e produktivitetit përmes investimeve dhe adoptimit të teknologjisë që mund të nxisë konvergjencën me Evropën Perëndimore, të ndihmojë në zvogëlimin e hendekut të pagave, e për rrjedhojë të frenojë flukset e emigrimit. Por kjo varet shumë nga gjendja e kapitalit të duhur njerëzor, i cili krijohet nëpërmjet arsimimit dhe aftësive profesionale. Ka ardhur koha që arsimi dhe kualifikimi i forcës punëtore të vendosen në listën e parë të prioriteteve të vendit. Gjithashtu, modeli i rritjes ekonomike të fortë në afatin e gjatë kërkon vëmendje të veçantë në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës "tradicionale", ashtu dhe të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Mundësitë dhe sfidat për sektorin financiar

Përveç tendencave globale dhe perspektivës ekonomike rajonale, transformimi që po ndodh në sektorin financiar përbën një tjetër sfidë, që ka të bëjë me ristrukturimet e bankave në rajon, evoluimin e kuadrit rregullator të sistemit financiar dhe inovacionet teknologjike veçanërisht në mjetet e pagesave. Të gjitha këto sfida kanë implikime të qenësishme për rregullimin dhe mbikëqyrjen

e sistemit financiar, ashtu dhe për implementimin e tyre me qëllim rritjen e eficiencës së tregut dhe përmirësimin e efektshmërisë së politikave të bankës qendrore nëpërmjet sektorit bankar.

Përgjithësisht, të dhënat më të fundit të Bankës së Shqipërisë tregojnë se sektori bankar paraqitet i shëndetshëm. Është shumë inkurajues fakti që kredia me probleme është reduktuar ndjeshëm, falë shlyerjeve, fshirjeve të kredive të humbura dhe sigurisht masave të marra për ristrukturimin e kredive. Për më tepër, testet e rezistencës së bankave tregtare vlerësohen të kënaqshme, për shkak të ekspozimit të ulët të sistemit financiar ndaj rreziqeve të tregut, kapitalizimit dhe nivelit të aktiveve likuide më të lartë se minimumi i kërkuar nga kuadri rregullator i bankës qendrore.

Megjithatë, rritja e depozitave bankare në monedhë të huaj kohët e fundit mund të shihet si shqetësim. Ky zhvillim pasqyron praninë e gjerë të monedhës së huaj në ekonominë tonë, e cila në kushte të caktuara mund të kërcënojë stabilitetin financiar. Kjo ka shtyrë Bankën e Shqipërisë të ndërmarrë veprimet konkrete në zbatim të Memorandumit Ndërinstitucional për Fuqizimin e Përdorimit të Monedhës Vendase, me qëllim uljen e përdorimit të valutës në ekonomi.

Prania e investimeve të huaja në sektorin bankar është gjykuar, ashtu si për industritë prodhuese ashtu dhe nxjerrëse, se përshpejton procesin e zhvillimit të vendit pritës në linjë me ekonomitë e avancuara nëpërmjet rritjes së eficiencës, transferimit më të lartë të teknologjisë, pagave më të larta, e më shumë mundësi. Megjithatë, pas krizës financiare globale, vendet e zhvilluara të goditura më fort nga kriza shfaqen gjithnjë e më pak të interesuara për të ruajtur investimet jashtë vendit. Ky ristrukturim i tyre kërkon një administrim të kujdesshëm. Çfarëdo drejtimi të marrë strategjia e vendeve të zhvilluara, angazhimet tona institucionale nuk duhet të ndalen nga rruga për liberalizimin e tregut të shërbimeve financiare, dhe në iniciativat e ndërmarra për forcimin e koordinimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrjes.

Banka qendrore, nga ana e saj, duhet të vazhdojë të ruajë qasjen e përshtatshme mbikëqyrëse të deritanishme, për të siguruar që aktiviteti financiar të vijojë të kryhet sipas standardeve më të mira të qeverisjes, për të siguruar kushtet për një mbështetje thelbësore financiare, njerëzore dhe teknike, që në kthim të japin frytet për një rritje ekonomike të qëndrueshme në funksion të mirëqenies, punësimit dhe kohezionit social.

DIFERENCAT NË PAGA NË VARËSI TË SEKTORIT TË PUNËSIMIT, NIVELIT ARSIMOR DHE GRUP-PROFESIONIT NË SHQIPËRI

Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

ABSTRAKT

Të shqyrtuarit e tipareve të tregut të punës së një vendi që lidhen me shpërndarjen e të ardhurave, është një nga angazhimet kryesore të ekonomisë së punës. Karakteristikat e procesit të shpërndarjes së pagave në tregun shqiptar të punës mbeten gjerësisht të paeksploruara nga pikëpamja e të dhënave mikro. Ky artikull kontribuon në shtimin e literaturës vendase të kërkimit ekonomik, duke ofruar një vlerësim tri-planësh mbi gjendjen dhe dinamikat e: hendekut të pagave të sektorit publik-privat, primet e pagave të tri niveleve arsimore kryesore, dhe diferencat e pagave midis dhjetë grup-profesioneve kryesore. Sa më sipër kryhet duke analizuar katër flukse të dhënash të anketës së familjeve AMNJ (Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës), të mbledhura gjatë periudhës 2002-2012 nga Instituti i Statistikave, nëpërmjet përqasjeve metodike të përdorura në teorinë e kapitalit njerëzor. Evidentimet kryesore për kampionin në fjalë dhe periudhën kohore të shqyrtuar janë: [1] sektori publik ofroi paga rreth 2.5% më të larta se ai privat, dhe hendeku i pagave ndërsektoriale paraqet një trend rritës; [2] të punësuarit me arsim të lartë u paguan rreth 50% mbi masën mesatare të pagave të siguruara nga të punësuarit me arsim të mesëm; [3] "Punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit" rezultuan i vetmi grup-profesion i pozicionuar nën mesataren e pagave që shfaq një trend rënës në largim nga mesatarja, gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar.

Fjalë kyçe

Shpërndarje e të ardhurave nga pagat, diferencë në pagë, sektor punësimi, nivel arsimor, grup-profesion, treg pune, Shqipëri.

Klasifikimi JEL: C21, J16, J31, J45.

HYRJE

Tregu shqiptar i punës mbetet një terren kërkimor pak i eksploruar kur bëhet fjalë për të dhënat mbi komponentët kryesorë të tij. Shumica e serive të disponueshme makroekonomike, përfshirë dhe seritë e tregut të punës, mbulojnë periudha kohore relativisht të shkurtra dhe shfaqin çështje serioze të vlefshmërisë së të dhënave (Fullani, 2005), çka i bën ato problematike për të kryer vlerësime dhe rrjedhimisht për të ndërtuar politika të mbështetura në rezultate kërkimore. Ndaj bëhet e domosdoshme për të grumbulluar të dhëna, prej të cilave të mund të sigurohen rezultate dhe evidentime nga burimet më të

pasura të informacionit mikroekonomik empirik - anketimet e kryera në njësitë ekonomike individuale dhe familjet.

Fokusi i kësaj pune kërkimore është të zbulojë disa nga veçoritë kryesore të shpërndarjes së pagave në tregun shqiptar të punës - saktësisht: diferencat në të ardhura nga pagat ndërmjet të punësuarve që rezultojnë nga zgjedhja e sektorit të punësimit, niveli arsimor dhe grup-profesioni - duke u mbështetur në standardin e metodikave të kapitalit njerëzor dhe duke përdorur të dhënat ekonomike mikro të disponueshme për Shqipërinë. Sondazhi më gjithëpërfshirës që ofron të dhëna të tilla është AMNJ-ja për Shqipërinë, një organizim i mbledhjes së të dhënave me shumë qëllime i realizuar në nivel familjeje, prej vitit 2002 e tutje nga INSTAT (Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2014), i cili gjithashtu ofron informacion ekonomik. Të dhënat e mbledhura mbulojnë fusha të tilla si të ardhurat mujore nga punësimi apo burime të tjera, mosha dhe gjinia e subjektit, vitet e përfunduara të arsimit formal, kohëzgjatja e punësimit me punëdhënësin aktual etj.

Bazuar në informacionin e marrë nga të dhënat bruto, hipotezat e kërkimit janë: [1] në terma mesatarë, në tregun shqiptar të punës, pagat e shpërndara në sektorin privat janë më të ulëta se ato të shpërndara në sektorin publik, dhe [2] duke qenë që punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit përbëjnë grup-profesionin që investon me numrin më të ulët të viteve në arsim formal, ky grup-profesion pritet të ketë mesataren më të ulët të pagave. Rezultatet kryesore të studimit janë përmbledhur më poshtë:

- Sektori publik ka ofruar gjatë periudhës së shqyrtuar, një prim pagash prej 7% krahasuar me nivelin e pagave të sektorit privat; sektori privat ofroi paga më të larta në vitin 2002, por duke filluar nga viti 2005, sektori publik ka paguar vazhdimisht më shumë, hendeku ndërsektorial i pagave ka paraqitur një trend rritës;
- Mesatarja e primit të pagave të të punësuarve me arsim të mesëm krahasuar me ata me arsim fillor rezultoi në rreth ¼, dhe ajo e të punësuarve me arsim të lartë krahasuar me ata me arsim të mesëm rezultoi në rreth ½;
- Diferencat e pagave midis grup-profesioneve tregojnë se, në terma mesatarë, punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit sigurojnë pagat më të ulëta (rreth 3/5 nën mesataren), ndërsa "Menaxherët" sigurojnë pagat më të larta (rreth 2/5 mbi mesataren).

Artikulli është i strukturuar siç vijon. Seksioni I ofron një përmbledhje të përgjithshme të literaturës empirike në të cilën bazohet qasja metodike e artikullit. Ajo rendit kontribuesit kryesorë të hulumtimit teorik të kapitalit njerëzor, dhe eksploron teknikat e tyre të metodologjisë. Ky seksion përmend dhe veprat empirike të autorëve bashkëkohorë, punët kërkimore të të cilëve kanë pasur një fokus të krahasueshëm me këtë kërkim. Seksioni II detajon metodologjinë e përdorur për të marrë rezultatet e studimit. Seksioni III jep një përmbledhje të detajuar të veçorive të të dhënave të AMNJ-së. Seksioni IV paraqet rezultatet e studimit dhe gjetjet. Seksioni V mbyll artikullin përmes një liste përfundimesh dhe implikimesh të nxjerra nga rezultatet dhe gjetjet e tij.

SEKSIONI I: SHQYRTIM LITERATURE

Teoria e përfitimit të kapitalit njerëzor postulon se konkurrueshmëria e një vendi në tregun global varet nga mundësitë e zhvillimit të aftësive që ai vend i ofron forcës së tij të punës. Prandaj, nivelet e larta të zhvillimit arsimor dhe trajnimit në vendin e punës do të sigurojnë konkurrencë ekonomike, e cila për rrjedhojë do të çojë në prosperitet dhe nivele të ulëta të papunësisë (Francis & Skelton, 2005). Koncepti themelor aplikativ që shoqëron këtë teori, i njohur gjerësisht si funksioni i të ardhurave nga kapitali njerëzor, pohon se shpërndarja probabilitare e investimeve neto në kapital njerëzor dhe ajo e të ardhurave janë të lidhura (Mincer, 1974). Në këtë kontekst, përpjekjet e një të punësuari për arsimim dhe sigurim të përvojës së punës në parim shoqërohen me rritje të nivelit të tij të kompensimit në tregun e punës. Thënë këto, është e qartë se faktorë të tjerë që lidhen me pagën e të punësuarit, të tillë si orari i punës, sektori i punësimit, grup-profesioni dhe gjinia, duhet gjithashtu të merren në konsideratë.

Themelet e kërkimit empirik në sferën e kapitalit njerëzor u hodhën në vitet '60 dhe '70 nga veprat qendrore të ekonomistëve bashkëkohës amerikanë Schultz, Becker dhe Mincer. Përpjekjet e tyre u përqendruan në konceptualizimin e kapitalit njerëzor si një përpjekje për investim personal dhe propozimin e kuadraturës së qartë ekonometrike që do të materializonte këtë koncept në lëmin empirik. Instrumenti ekonometrik më i spikatur i kësaj kuadrature, i njohur si "funksioni i të ardhurave të Mincerit", u propozua nga Mincer në botimin e tij të gjithënjohur "Schooling, Experience and Earnings" (1974). Blinder & Oaxaca e pasuruan kërkimin empirik, duke hulumtuar gjatë së njëjtës periudhë kohore, mbi shkaqet e diferencave në paga të të punësuarve që i atribuohen karakteristikave të lindura të subjektit, siç janë raca dhe gjinia, dhe kontribuan nëpërmjet propozimit të një serie metodash dekompozimi, të sintetizuara më vonë në atë që njihet si "metoda e dekompozimit Blinder-Oaxaca".

Përpjekjet kërkimore të mëpasshme në këtë fushë, të tilla si Hirsch (1978), e më vonë Suh (2007), Depalo, et al. (2013), Abel & Deitz (2014), etj., eksploruan mënyra për të përfshirë idetë e Blinder dhe Oaxaca në strukturën e funksionit Mincerian, kryesisht me qëllim krahasimin e kategorive të të ardhurave nga tregu i punës, të tilla si vendet, industritë, profesionet, racat, grup-moshat, etj. Në dekadat e fundit, versionet me variabla të shtuara të funksionit Mincerian janë përdorur për një shumëllojshmëri qëllimesh vlerësimi, lidhur me të ardhurat e siguruara nga tregu i punës. Arsyeja për shtimet e variablave shpjegues lidhet me faktin se të ardhurat e një individi nuk mund të shpjegohen plotësisht përmes nivelit të tij të kapitalit njerëzor, ndaj, përfshirja e termave shpjegues shtesë mund të ndihmojë në një shpjegim më të mirë të ndryshueshmërisë së variablit të varur.

Për aq sa e njohim literaturën, ekzistojnë dy studime empirike që përdorin funksionin e të ardhurave nga kapitali njerëzor dhe përqendrohen ekskluzivisht në rastin e Shqipërisë: Gjipali & Kristo (2011), dhe Psacharopoulos (2017). Të dy studimet përdorin të dhënat mikro të AMNJ-së për Shqipërinë, përkatësisht të viteve 2002 dhe 2012. Studimi i Gjipali & Kristo (2011) shqyrton efektet që arsimi i mesëm

dhe i lartë kanë tek të ardhurat dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor të punonjësve shqiptarë, ndërsa studimi i Psacharopoulos (2017) ka objektivin më të gjerë të vlerësimit të humbjeve financiare në shkallë vendi, të shkaktuara nga niveli aktual i nëninvestimit në arsimin formal. Rezultatet e tyre, bazuar në versionet përkatëse të funksionit të të ardhurave, shfaqin përputhshmëri për faktin që të dy tregojnë marrëdhënie statistikisht të rëndësishme dhe pozitive midis kohës shtesë të investuar në arsimin formal dhe të ardhurave të siguruara në tregun e punës.

Ndërmarrja e këtij projekti kërkimor u nxit nga një mangësi e njohurive të sakta sasiore për hendekun aktual të të ardhurave nga pagat midis sektorit publik dhe atij privat në Shqipëri. Gjatë kryerjes së këtij kërkimi u synua përdorimi i informacionit mikro të AMNJ-së i përbërë nga katër flukse të dhënash, përkatësisht të viteve 2002, 2005, 2008 dhe 2012 - për të kryer një shqyrtim tri-planësh të gjendjes dhe dinamikave të:

[i] hendekut mbizotërues të pagave midis sektorit publik dhe privat në Shqipëri;
[ii] primeve të pagave për tre nivelet kryesore të arsimimit (fillor, të mesëm dhe të lartë), krahasuar me një grup kontrolli të të punësuarve që janë pa arsim;
[iii] diferencave të pagave ndërmjet dhjetë grup-profesioneve, [siç janë të përcaktuara me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës; shih ISCO-88, (Hoffmann, 1999)];

gjatë periudhës kohore 2002-2012.

Është e rëndësishme të theksohet fakti që, për të ruajtur njëtrajtshmërinë e të dhënave të sondazhit, përfshihen në analizë vetëm të dhëna të mbledhura nga të punësuarit me kohë të plotë, të përfshirë në listën e pagave të një punëdhënësi, dhe të punësuar prej jo më pak se 1 vit nga kryerja e sondazhit. Kushtet e mësipërme u siguruan duke eliminuar subjektet që përgjatë një viti deri në momentin e kryerjes së sondazhit, raportuan:

- paga të paqëndrueshme, apo të parregullta sa i përket periodicitetit;
- punësim me kohë të pjesshme, sezonal apo të bazuar në projekte;
- punësim familjar apo vetëpunësim;
- periudha papunësie apo inaktiviteti ekonomik.

Pyetja kryesore për t'iu përgjigjur pas kryerjes së analizës empirike të këtij studimi është: Cilat janë diferencat në paga midis: [i] sektorëve privat dhe publik të punësimit; [ii] dhjetë grup-profesioneve kryesore, dhe; [iii] niveleve kryesore të arsimimit në Shqipëri, dhe si ka qenë ecuria e këtyre diferencave gjatë periudhës 2002-2012?

Studimi ndryshon nga studime të mëparshme me të njëjtin fokus mbi Shqipërinë, për faktin që përdor të dhëna mikro nga AMNJ-ja, të marra nga katër flukse të dhënash, përkatësisht të viteve 2002, 2005, 2008 dhe 2012, dhe raporton rezultate mbi gjendjen dhe dinamikat e diferencave në paga për dy sektorët e punësimit, tri nivelet e arsimit formal, dhe dhjetë grup-profesionet. Vlera e shtuar

e tij në literaturën ekzistuese mbi Shqipërinë konsiston në faktin se përcakton se cili sektor i punësimit siguron të ardhura më të larta gjatë periudhës 2002-2012 (Gjipali & Kristo raportojnë rezultatet e hendekut të pagave që lidhen me sektorin e punësimit vetëm për vitin 2002; ndërkohë studimi ynë e gjurmon trendin e hendekut të të ardhurave deri në vitin 2012). Një risi e këtij studimi është renditja e mesatareve të pagave sipas grup-profesionit.

Nisur nga literatura e lartpërmendur, ky studim përdor funksionin e të ardhurave nga kapitali njerëzor për të eksploruar efektet që kapitali njerëzor i një individi, sektori i punësimit dhe zgjedhja e profesionit mund të kenë në të ardhurat që ky i fundit siguron nga punësimi në tregun shqiptar të punës. Qëllimi i tij është të kryejë një analizë ekonometrike, që synon të përcaktojë se cili sektor (privat ose publik) ofron të ardhura më të larta individuale dhe të identifikojë diferencat në të ardhura nga punësimi, në nivelet kryesore të arsimit dhe grup-profesionet.

SEKSIONI II: METODOLOGJIA

Bazuar në rishikimin e literaturës (Hirsch (1978), Lemieux (2006), Gjipali dhe Kristo (2011)), dhe Abel dhe Deitz (2014), instrumenti ekonometrik, i aplikuar për të katër flukset e disponueshme të të dhënave, specifikohet si më poshtë:

(1)	*(specifikimi bazë)*	$LWag_t = LWag_{0,t} + \alpha Edu_t + \beta_1 Exp_t + \beta_2 Exp^2_t + \delta Hour_t + \varphi Male_t + \varepsilon_t$	
(2)		--- (1) ---	$+ \theta Sect_t$
(3)	*(αEdu_t e papërfshirë)*	--- (1) ---	$+ \sum_{i=2}^{4} \pi_i LE_{i,t}$
(4)		--- (1) ---	$+ \sum_{j=2}^{10} \omega_j Occ_{j,t}$

Ku:

t një nga katër vitet e kryerjes së anketës (2002, 2005, 2008 dhe 2012) që përfshihen në vlerësim;

LWag variabli i varur - logaritmi natyror i të ardhurave mujore të të punësuarit nga punësimi;

$LWag_0$ intercept – logaritmi natyror i të ardhurave mujore nga punësimi që teorikisht do të siguroheshin nga një i punësuar pa arsim formal dhe pa përvojë në tregun e punës;

Edu variabël shpjegues – numri i viteve të përfunduara të arsimit formal;

Exp variabël shpjegues – numri i viteve të përvojës së supozuar[1] në tregun e punës, përafërsisht i llogaritur si Age – 6 – Edu;

Exp^2 termi kuadratik i Exp – siguron trendin rënës të të ardhurave mujore në vitet e fundit të karrierës në profesion;

Hour variabël shpjegues – numri i orëve tipike të punës në javë;

Male Variabël *dummy* – tregon gjininë e subjektit, duke e caktuar çdo vrojtim 1 nëse subjekti është burrë, dhe 0 nëse është grua;

Sect Variabël *dummy* – vlerëson hendekun e të ardhurave mujore ndërmjet sektorëve të punësimit, duke caktuar çdo vrojtim 1 në rast të punësimit në sektorin publik, dhe 0 në të kundërt;

[1] *Mincer introduced the measure of potential labour market experience as a standard regressor of the earnings equation in his influential article "Schooling, Experience and Earnings" (1974), to approximate the timespan of a working individual's age, minus pre-school years, minus formal education years (Lemieux, 2006).*

LE$_i$ Set variablash *dummy* – vlerëson primet e të adhurave mujore për tri nivelet kryesore të arsimit formal (fillor, të mesëm, të lartë), në krahasim me një grup kontrolli të atyre që janë pa arsim fillor, duke e caktuar çdo vrojtim 1 për nivelin përkatës të arsimit formal i, dhe 0 në të kundërt;

Occ$_j$ Set variablash *dummy* – vlerëson diferencat midis të adhurave mujore për dhjetë grup-profesionet sipas ISCO-88 duke i krahasuar me mesataren, dhe duke e caktuar çdo vrojtim 1 për grup-profesionin përkatës j, dhe 0 në të kundërt.

(1) është specifikimi bazë i modelit; përfshihet në procedurën e vlerësimit vetëm për të dhënë rezultate mesatare për të gjithë kampionin. (2) përdoret për të bërë dallimin midis dy sektorëve të punësimit, (3) midis tri niveleve të arsimimit dhe (4) midis grup-profesioneve. Për të kryer llogaritjet, variablat e kontrollit Edu, Exp, Hour dhe Male mbahen në vlerat mesatare të kampionit përkatës. Vlen të përmendet që, duke qenë se variablat Edu, Exp, Hour dhe Male janë të ndryshëm për sektorë punësimi, nivele arsimi dhe grup-profesione të ndryshme, mesataret e vrojtuara të pagave për këto kategori gjithashtu do të rezultojnë të ndryshme nga rezultatet ekonometrike që siguron seti i ekuacioneve të sipër-listuara. Për t'iu përmbajtur parimit *ceteris paribus*, rezultati i tendencës qendrore të marrë nga modeli ekonmetrik preferohet, krahasuar me mesataren e pagave të marra nga të dhënat përshkruese.

Përfshirja në setin e variablave shpjegues e Hour është një karakteristikë kryesore e modelit. Edhe pse Mincer nuk i përfshiu orët e punës në strukturën teorike të modelit (Mincer, 1974), në punët e tij të mëvonshme kërkimore ai theksoi se orët e punës janë një përcaktues i rëndësishëm i pagave pasi, veçanërisht tek punonjësit me përvojë, u vërejt se "orari preferencial negociohej në këmbim të pagave më të ulëta" (Mincer, 1986). Orët e punës në javë janë raportuar në mënyrë konsistente, në të gjitha flukset e të dhënave mikro të AMNJ-së, dhe efekti marzhinal i Hour pritet të jetë i rëndësishëm në të gjitha vlerësimet ekonometrike.

Hirsch (1978) dhe Suh (2007) i ndanë të dhënat në dispozicion të tyre, respektivisht sipas klasifikimit profesional dhe sektorit të punësimit, në mënyrë që të sigurojnë analiza regresi për raportim të rezultateve në bazë të kategorizimit. Për shkak të numrit të kufizuar të vrojtimeve në kategori të ndara, në rastin tonë ndarja e të dhënave nuk siguroi rezultate statistikisht të rëndësishme, prandaj u gjykua më praktike të përdoren variabla *dummy* për të bërë dallimin për sektorët e punësimit, nivelet e arsimit formal dhe grup-profesionet në të dhënat tona.

SEKSIONI III: TË DHËNA PËRSHKRUESE

Ky studim përdor katër flukse të dhënash, që u përkasin viteve 2002, 2005, 2008 dhe 2012, dhe përmbajnë një total prej 14.863 vrojtimesh. Informacioni i siguruar nga këto flukse të dhënash është i mjaftueshëm për

të kryer analiza regresi *cross-section* per secilin vit, me qëllim nxjerrjen e rezultateve që lidhen me fokusin e këtij studimi. Tabela 1 paraqet në menyrë të përmbledhur karakteristikat e të dhënave. Grup-profesionet specifikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 2017, nr. 514, dhe mbajnë kodimin origjinal ISCO-88, siç detajohet në Shtojcën 1.

Tabelë 1 Ndarja e të anketuarve sipas sektorit të punësimit dhe nivelit arsimor

		Sektori		Niveli Arsimor			
		Privat	Publik	Pa arsim	Fillor	i mesëm	i lartë
Viti	2002	52%	48%	3%	30%	45%	22%
	2005	71%	29%	5%	35%	45%	15%
	2008	72%	28%	3%	40%	41%	16%
	2012	73%	27%	3%	32%	37%	28%
Total	Vrojtime:	10194	4669	540	5112	6125	3086
	Përqind:	69%	31%	4%	34%	41%	21%
		100%		100%			

Burimi: Të dhënat mikro nga AMNJ, 2002-2012

Katër grupet e të dhënave që disponojmë tregojnë se mesatarisht 31.4% e të punësuarve rezultojnë të punësuar në sektorin publik. Vlen të nënvizohet sidoqoftë, se kjo normë ishte veçanërisht e lartë në vitin 2002 (rreth 48%). Kjo pjesërisht mund të ketë ardhur si rezultat i një plogështie shkëputjeje nga një infrastrukturë e centralizuar punësimi, e trashëguar nga sistemi i mëparshëm politik i vendit, dhe pjesërisht për shkak të variacionit në kampion. Sidoqoftë, shkalla e punësimit në sektorin publik ka shfaqur një trend në rënie qysh atëherë, me rreth 29%, 28% dhe 27% në përkatësisht 2005, 2008 dhe 2012.

Arsimi formal zgjat mesatarisht rreth 10.2 vjet tek të punësuarit në sektorin privat, ndërsa tek ata në sektorin publik, rreth 13.3 vjet (afërsisht një devijim standard më lart). Grafiku në Shtojcën 2 ofron një paraqitje vizuale krahasuese të profileve të të ardhurave për dy sektorët e punësimit, të kategorizuar sipas nivelit të arsimimit. Siç vihet re në grafik, përgjithësisht, sektori publik paguan në mënyrë konsistente më shumë se sektori privat – së paku deri në vitin e 15-të të arsimit formal. Vetëm në kategorinë e të punësuarve me arsim më të thelluar se arsimi universitar tipik, të punësuarit në sektorin privat, duket se sigurojnë paga disi më të larta krahasuar me ato të të punësuarve në sektorin publik (madje dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një pjesë mjaft të vogël të kampionit – rreth 13% – kështu që variacioni në kampion mund të luajë një rol dhe në këtë rast).

Grafik 1. Diferenca e vrojtuar e pagave krahasuar me mesataren, dhe vitet e arsimit formal, për çdo grup - profesion



Burimi: Të dhënat mikro të AMNJ, 2002-2012.

Grafiku 1 tregon lidhjen midis viteve mesatare të arsimit dhe nivelit të vrojtuar të të ardhurave nga pagat, për çdo grup-profesion. Në përgjithësi, ato profesione që paraqesin mesatare më të ulëta të viteve të shpenzuara për arsimim, paraqesin gjithashtu nivele pagash që janë nën ose pranë nivelit të pagës mesatare për kampionin, ndërsa ato profesione që paraqesin mesatare më të ulëta të viteve të shpenzuara për arsimim, paraqesin gjithashtu nivele pagash konsiderueshëm më lart se paga mesatare.

Duke marrë në konsideratë detajet e lartpërmendura dhe duke pasur parasysh parimet e teorisë së përfitimit të kapitalit njerëzor (Mincer, 1974; Francis & Skelton, 2005), pritshmëritë e autorit janë që të ardhurat nga pagat në sektorin privat të jenë më të ulëta se ato në sektorin publik, dhe punonjësit që angazhohen në profesione që kërkojnë nivel më të ulët arsimimi, të sigurojnë gjithashtu paga mesatare më të ulëta. Edhe hipotezat e studimit të shtruara më sipër bazohen në këto supozime.

Këto supozime mbështeten në arsyetimin se, në terma mesatarë, të punësuarit në sektorin publik investojnë rreth 3.1 vjet më shumë në arsimim krahasuar me të punësuarit në sektorin privat, kështu që pritshmëritë e tyre për kthimin nga investimi në kapital njerëzor do të jenë më të larta. Duke ndjekur të njëjtin arsyetim, grup-profesionet që investojnë numër më të paktë vitesh në arsimim pritet të kenë mesatare më të ulëta të të ardhurave të siguruara nga pagat. Për analogji, grup-profesionet që investojnë numër më të shumtë vitesh në arsimim duhet të kenë mesatare më të larta të të ardhurave të siguruara nga pagat.

SEKSIONI IV: REZULTATE, EVIDENTIME DHE KRAHASIME

Më poshtë paraqitet rezultati i analizës së regresit *cross-section* e përsëritur, sipas specifikimit bazë (1) në seksionin e metodologjisë, i kryer për të gjitha vëzhgimet e disponueshme, që mbulon të katër flukset e të dhënave nga anketa e AMNJ-së. Në të përfshihen termi R^2, numri i vrojtimeve dhe vlerat e rëndësisë probabilitare (në kllapa).

$$
\begin{aligned}
LWag = \; & \underset{(0.000)}{8.7731}\, LWag_0 + \underset{(0.000)}{0.0217}\, Exp - \underset{(0.000)}{0.0004}\, Exp^2 + \underset{(0.000)}{0.0113}\, Hour \\
& + \underset{(0.000)}{0.3317}\, Male + \underset{(0.000)}{0.1335}\, Elem_ed + \underset{(0.000)}{0.3836}\, High_sc + \underset{(0.000)}{0.8772}\, Univ
\end{aligned}
$$

$$R^2 = 25.9\%$$

$$\text{Obs:} \quad 14{,}863$$

Rezultati i mësipërm, për fuqinë punëtore shqiptare të punësuar gjatë harkut kohor 2002-2012, mund të perifrazohet si më poshtë:

Duke supozuar se të gjitha kushtet e tjera të tregut të punës mbahen të pandryshuara:

1. çdo vit shtesë në arsim formal shoqërohet me një rritje mesatare prej 8.2% të të ardhurave të të punësuarit nga paga;
2. çdo vit shtesë në përvojën e tregut të punës shoqërohet me një rritje mesatare prej 1.7% të të ardhurave të të punësuarit nga paga;
3. çdo orë pune në javë shtesë shoqërohet me një rritje mesatare prej 1.1% të të ardhurave të të punësuarit nga paga;
4. burrat siguruan një prim page që mesatarisht rezulton të jetë 37.5% mbi mesataren e pagave të grave.

Në lidhje me hipotezën 1, duke supozuar një nivel page të axhustuar për inflacionin, dhe që kushtet e tjera të tregut mbahen të pandryshuara, rezultati i analizës së regresit *cross-section* e përsëritur sipas specifikimit (2) tregon se, gjatë periudhës dhjetëvjeçare të marrë në shqyrtim, të ardhurat nga pagat e të punësuarve në sektorin publik rezultojnë 2.5% më të larta se ato të të punësuarve në sektorin privat (variabli i sektorit del statistikisht i rëndësishëm për nivelin 5% të rëndësisë). Ky rezultat konfirmon hipotezën 1, duke evidentuar se në terma mesatarë, sektori publik në Shqipëri ofron paga më të larta. Sidoqoftë, duhet të theksohet se kur bëhet vlerësimi për kampionet veç-e-veç, rezultatet nuk dalin të ngjashme. Siç vihet re në Grafikun 2, në vitin 2002, efekti marzhinal ishte negativ: - 17%. Kjo mbështet evidentimin e Gjipali dhe Kristo (2011) se, në vitin 2002, "sektori publik ofroi paga më të ulëta se ai privat."

Grafik 2. Efekti në pagë i punësimit në sektorin publik, 2002-2012
(krahasuar me nivelin e pagave në sektorin privat)



Burimi: Të dhënat mikro të AMNJ, 2002-2012.

Sidoqoftë, vlerësimet e viteve në vijim tregojnë se ky efekt negativ u kthye në pozitiv në vitin 2005, dhe mbeti i tillë gjatë gjithë periudhës së shqyrtuar. Në vitin 2012, të ardhurat nga pagat për të punësuarit në sektorin publik rezultuan 14% më të larta se ato për të punësuarit në sektorin privat.

Në lidhje me diferencat e të ardhurave nga pagat për nivelet kryesore të arsimit formal, llogaritjet në bazë të rezultatit të marrë nga një analizë regresi *cross-section* e përsëritur, sipas specifikimit (3) (paraqitur më poshtë), tregojnë se krahasuar me një grup kontrolli të të punësuarve pa arsim formal: [1] përvetësimi i një diplome të arsimit fillor shoqërohet me një rritje mesatare të nivelit të pagës mujore prej 14.3%; [2] përvetësimi i një diplome të arsimit të mesëm shoqërohet me një rritje mesatare të nivelit të pagës mujore prej 46.8%, dhe; [3] përvetësimi i një diplome universitare shoqërohet me një rritje mesatare të nivelit të pagës mujore prej 140.4%. Paraqitur në mënyrë alternative, një i punësuar me arsim të mesëm siguroi të ardhura mujore 25% më të larta se një i punësuar me arsim fillor, ndërsa një i punësuar me arsim të lartë siguroi të ardhura mujore 49.3% më të larta se një i punësuar me arsim të mesëm. Për efekt krahasimi, primet e të punësuarve me arsim të mesëm, mbi pagat e të punësuarve me arsim fillor, në Evropë variojnë nga 8% në 78%, ku ekonomitë më të zhvilluara të Evropës Perëndimore e Veriore duket se kanë prime pagash më të ulëta, ndërsa ekonomitë në tranzicion të Evropës Lindore kanë prime pagash më të larta (Badescu, D'Hombres, & Villalba, 2011). Mesatarja e primit të pagës në Shqipëri prej 25% (që të punësuarit me arsim të mesëm e përfitojnë, mbi pagën mesatare të të punësuarve me arsim fillor) përket diku në mes të intervalit të lartpërmendur për Evropën.

$$
\begin{aligned}
LWag = {} & \underset{(0.000)}{8.7731}\ LWag_0 + \underset{(0.000)}{0.0217}\ Exp - \underset{(0.000)}{0.0004}\ Exp^2 + \underset{(0.000)}{0.0113}\ Hour \\
& + \underset{(0.000)}{0.3317}\ Male + \underset{(0.000)}{0.1335}\ Elem_ed + \underset{(0.000)}{0.3836}\ High_sc + \underset{(0.000)}{0.8772}\ Univ
\end{aligned}
$$

$R^2 = 25.9\%$

Obs: 14,863

Grafik 3. Diferencat nga mesatarja e pagave sipas nivelit arsimor, 2002-2012



Burimi: Të dhënat mikro të AMNJ, 2002-2012.

Për sa i përket krahasimit të Shqipërisë me rajonin fqinj, të dy tabelat në Shtojcën 1 paraqesin: [1] si Shqipëria renditet në mesin e fqinjëve të saj në lidhje me primet e pagave për sektorin publik, dhe; [2] si Shqipëria krahasohet me ekonomitë e zhvilluara, dhe ato në tranzicion, në Evropë kur bëhet fjalë për rritje të ardhurash të siguruara nga investimi në arsimim.

Grafiku 3 mundëson një kuptim më të mirë të mesatareve të të ardhurave mujore, dhe të ecurive të tyre përgjatë viteve, për secilin prej niveleve të arsimimit. Pagat e kategorive të të punësuarve pa arsim formal dhe me arsim fillor shfaqin trend rënës me largim nga mesatarja. Pagat e të punësuarve me arsim të mesëm kanë tendencë të qëndrojnë tek mesatarja. Pagat e të punësuarve me arsim të lartë paraqiten të stacionuara diku tek 55% mbi mesataren (por shfaqin një trend rënës në vitet e fundit të periudhës së shqyrtuar).

Grafik 4. Diferencat nga mesatarja e pagave sipas grup-profesionit, 2002-2012.



Burimi: Të dhënat mikro të AMNJ, 2002-2012.

Bazuar në analizat e regresit sipas specifikimit (4) për secilin vit, Grafiku 4 ofron të njëjtin zbërthim vizual si në Grafikun 3, këtë herë për secilin grup-profesion. Shihet qartë se "Punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit" siguruan pagat më të ulëta (rreth 37% nën mesataren), ndërsa "Menaxherët" (të ndjekur nga "Specialistët me arsim të lartë") siguruan pagat më të larta (rreth 50% mbi mesataren), gjatë periudhës së shqyrtuar. Të ardhurat nga pagat për grup-profesionet "Menaxherë", "Specialistë me arsim të lartë", "Teknikë dhe specialistëve në zbatim", "Nëpunës", dhe "Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve", shfaqin të gjitha tendencë në rritje, ndërsa të ardhurat nga pagat vetëm për "Forca të armatosura" dhe "Punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit" duket se kanë tendencë në rënie gjatë periudhës së shqyrtuar. Për më tepër, grafiku tregon se pagat e punonjësve të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit vetëm shfaqin një trend rënës me largim nga mesatarja.

Sa u përket diferencave në të ardhura mujore lidhur me gjininë, analiza e regresit *cross-section* e përsëritur sipas specifikimit (1), raportoi një hendek 37.5% midis burrave dhe grave, tregues i një pabarazie të konsiderueshme

në të ardhurat nga pagat gjatë periudhës 2002 -2012. Ndërkohë, analizat e regresit të kryera për kampione të ndara – sipas viteve – tregojnë se ky hendek shfaq tendencë ngushtimi përgjatë periudhës së shqyrtuar, që arrin deri në 28.5% në vitin 2012.

Së fundi, në lidhje me situatën e mundshme të variancës së pabarabartë të gabimeve, literatura ekonometrike e përqendron vëmendjen në procedurat e analizës së regresit që llogarisin vlerësuesit Huber-White (White, 1980). Duke supozuar shpërndarje normale të gabimeve, procedura të tilla gjenerojnë vlerësues më eficientë, duke e ankoruar matjen tek vrojtimet më të sakta (d.m.th. ato me katrorët më të vegjël të gabimeve), duke i atribuuar ndërkohë më pak peshë *outliers* (Froot, 1990). Të gjitha analizat e regresit në këtë studim kryhen duke përdorur këtë teknikë.

SEKSIONI V: VËREJTJE PËRMBYLLËSE

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të mundësonte një vlerësim empirik të diferencave në të ardhura nga pagat – për disa kategori të përzgjedhura të të punësuarve, siç janë sektorët e punësimit, nivelet e arsimit formal dhe grup-profesionet - të pranishme në Shqipëri gjatë periudhës së viteve 2002-2012.

Vlerësimet tregojnë se sektori publik ofron një prim të të ardhurave mujore nga pagat, i cili u vu re vetëm gjatë 7 viteve të fundit të periudhës së shqyrtuar (2005-2012); në vitin 2002, primi i përkiste sektorit privat të punësimit.

Në lidhje me diferencat në paga midis tre niveleve kryesore të arsimit formal, të dhënat tregojnë se të punësuarit me arsim të mesëm përcaktojnë pagën mesatare në tregun e punës. Mesatarja e primit të të punësuarve me arsim të mesëm mbi pagën e të punësuarve me arsim fillor është rreth ¼, dhe ajo e të punësuarve me arsim të lartë mbi pagën e të punësuarve me arsim të mesëm është rreth ½. Çka parashtrohet më lart mbështet supozimin se tregu shqiptar i punës duket se ofron kushte joshëse për pjesën të mirarsimuar të fuqisë punëtore. Një diplomë universitare siguron një ngritje të konsiderueshme të pagës për të punësuarin tipik shqiptar, ngritje e cila vërtet tregon vlerën dhe arsyet për konsideratën e lartë që njerëzit e thjeshtë ruajnë për arsimin e lartë në Shqipëri.

Një trend rënës vihet re tek të ardhurat nga pagat e të punësuarve me arsim të lartë në vitet e fundit të periudhës së shqyrtuar (konkretisht nga viti 2005 e tutje). Kjo mund të jetë për shkak të faktit se oferta e fuqisë punëtore me arsim të lartë në tregun e brendshëm të punës është rritur me kalimin e kohës, për pasojë, kërkesa për punë është axhustuar në përputhje me rrethanat duke ulur primin në pagat e kësaj kategorie punonjësish.

Referuar diferencave në të ardhurat nga pagat midis grup-profesioneve, spikat se, përveç pozicionimit në mënyrë konsistente nën mesataren e pagave, pagat e punonjësve të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit shfaqën një trend rënës përgjatë gjithë periudhës së shqyrtuar. Kjo çon në përfundimin

se profesionet e përfshira në këtë grup-profesion ishin më pak të preferuarat në tregun shqiptar të punës gjatë viteve 2002-2012. Duke supozuar vazhdimin e trendit rënës të nivelit të të ardhurave nga pagat për këtë grup-profesion deri në vitet e tanishme, qeveria, në bashkëpunim me rrjetin e ndërmjetësve financiarë në Shqipëri, duhet të mundësojë politika dhe programe që inkurajojnë rritjen e cilësisë së produkteve në bujqësi dhe peshkim. Masa të tilla duhet të planifikohen me qëllim stimulimin e konsumit të brendshëm të produkteve të kësaj fushe të aktivitetit ekonomik, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave të saj, e rrjedhimisht, në rritje të pagave të punonjësve në këtë grup-profesion.

REFERENCA

Abel, J. R., & Deitz, R. (2014, November 3). Do the Benefits of College Still Outweigh the Costs? Current Issues, fv. 1-11.

Badescu, M., D'Hombres, B., & Villalba, E. (2011). Returns to education in European countries: Evidence from the European Community Statistics on Income and Living Conditions. Joint Research Centre. Varese: European Commission.

Bank of Albania. (2014). First Quarter Monetary Policy Report. 21.

Bank of Albania. (2014). Second Quarter Monetary Policy Report. 22.

Baum, S. (2014). Higher Education Earnings Premium: Value, Variation, and Trends. Washington: Urban Institute. Gjetur në https://www.urban.org/sites/default/files/publication/22316/413033-Higher-Education-Earnings-Premium-Value-Variation-and-Trends.PDF

Becker, G. S. (1962). Investment in Human Capital: A Theoretical Analysis. Journal of Political Economy, 70(9).

Becker, G. S. (1967). Human Capital and the Personal Distribution of Income: An Analytical Approach. fv. 94–144.

Becker, G. S. (1975). Human Capital: A Theoretical and Empirical Analysis, with Special Reference to Education (bot. i 2nd). Cambridge, Massachusetts, United States of America: National Bureau of Economic Research.

Becker, G. S. (1975). Investment in Human Capital: Rates of Return. Në Human Capital: A Theoretical and Empirical Analysis, with Special Reference to Education (bot. i 2nd, fv. 45-144). National Bureau of Economic Research. Gjetur në http://www.nber.org/books/beck75-1

Blinder, A. (1973). Wage Discrimination: Reduced Form and Structural Estimates. The Journal of Human Resources, 436-455. Gjetur në http://www.jstor.org/stable/144855

Council of Ministers, Albania. (2017, September 20). Executive Order No. 514: On the adoption of the National List of Professions, revised. Tirana, Albania: Official Bulletin.

de Castro, F., Salto, M., & Steiner, H. (2013). The gap between public and private wages: new evidence for the EU. Directorate-General for Economic and Financial Affairs. Brussels: European Commission.

Depalo, D., Giordano, R., & Papapetrou, E. (2013). Public-private wage differentials in euro area countries: evidence from quantile decomposition analysis. Printing and Publishing Division. Rome: Bank of Italy.

Deschênes, O. (2001). Unobserved Ability, Comparative Advantage, and the Rising Return to Education in the United States 1979-2002.

Francis, B., & Skelton, C. (2005). Reassessing Gender and Achievement: Questioning Contemporary Key Debates. New York, USA: Routledge. doi:0-415-33324-5

Froot, K. A. (1990). Consistent Covariance Matrix Estimation with Cross-Sectional Dependence and Heteroskedasticity in Cross-Sectional Financial Data. National Bureau of Economic Research. doi:10.3386/t0062

Fullani, A. (2005). Fjala përshëndetëse. Probleme të politikës monetare dhe parashikimi i inflacionit (fv. 5-7). Tirana: Bank of Albania.

Gjipali, A., & Kristo, S. (2011). Mincer Rates of Return to Education in the Emerging Economy of Albania. Studies in Business and Economics, 27-36.

Heckman, j., Lochner, L., & Todd, P. (2003). Fifty Years of Mincer Earnings Regressions. Hirsch, B. (1978). Earnings, Occupation, and Human Capital Investment. Atlantic Economic Journal, 31-39.

Hoffmann, E. (1999). International Statistical Comparisons of Occupations and Social Structures: Problems, Possibilities and the Role of ISCO-88. Gjetur në International Labour Organization: http://www.ilo.org/global/statistics-and-databases/WCMS_087941/lang–en/index.htm

Iacobucci, D., Schneider, M., Popovich, D., & Bakamitsos, G. (2017). Mean centering, multicollinearity, and moderators in multiple regression: The reconciliation redux. Behav Res(49), 403-404. doi:10.3758/s13428-016-0827-9

Institute of Statistics. (2019). Administrative data on labour market. Tirana, Albania. Gjetur në http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/t%C3%AB-dh%C3%ABna-administrative-t%C3%AB-tregut-t%C3%AB-pun%C3%ABs/#tab1

Jud, G. D., & Winkler, D. T. (1998). The Earnings of Real Estate Salespersons and Others in the Financial Services Industry. Journal of Real Estate Finance and Economics, XVII(3), 279-291.

Lemieux, T. (2006). Post-secondary Education and Increasing Wage Inequality. American Economic Review, 96, 195-199. Gjetur në http://www.nber.org/papers/w12077.pdf

Lemieux, T. (2006). The "Mincer Equation" Thirty Years after Schooling Experience and Earnings. Në S. Grossbard, Jacob Mincer A Pioneer of Modern Labor Economics (fv. 124-149). Boston MA: Springer.

Living Standard Measurement Survey. (2014). Gjetur në INSTAT - Institute of Statistics: http://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/living-standard-measurement-survey/

Mincer, J. (1957). A Study of Personal Income Distribution. New York: Columbia University Press.

Mincer, J. (1958, August). Investment in Human Capital and Personal Income Distribution. The Journal of Political Economy, 66(4), fv. 281-302.

Mincer, J. (1974). Schooling, Experience, and Earnings. Cambridge, Massachusetts, USA: National Bureau of Economic Research.

Mincer, J. (1986). Wage Changes in Job Changes. Cambridge: National Bureau of Economic Research.

Neelakantan, U., & Romero, J. (2017). Falling Short: Why Isn't the U.S. Producing More College Graduates? Richmond: Federal Reserve Bank of Richmond.

Oaxaca, R. (1973). Male-Female Wage Differentials in Urban Labor Markets. International Economic Review, 14(3), 693-709.

O'Brien, R. (2007). A Caution Regarding Rules of Thumb for Variance Inflation Factors. Quality & Quantity(41), 673–690. doi:10.1007/s11135-006-9018-6

Psacharopoulos, G. (2017). Albania - The Cost of Underinvestment in Education: and Ways to Reduce It. Tirana: © United Nations Children's Fund (UNICEF).

Robinson, C., & Schumacker, R. (2009). Interaction Effects: Centering, Variance Inflation Factor, and Interpretation Issues. Multiple Linear Regression Viewpoints, XXXV(1), 6-11.

Schultz, T. W. (1960). Capital Formation by Education. Journal of Political Economy, 68(6), 571-583.

Shehaj, E., Loxha, A., & Pula, E. (2015). The public-private sector wage gap in Kosovo and Albania: an empirical perspective. Group for Legal and Political Studies. Prague: Global Development Network.

Suh, J. (2007). Decomposition of the Change in the Gender Wage Gap. Academic And Business Research Institute. Gjetur në http://www.aabri.com/manuscripts/08076.pdf

The Organisation for Economic Co-operation and Development. (2019). Dataset: Education and Earnings. OECD.Stats. Paris, France.

Vladisavljevic, M., Narazani, E., & Golubovic, V. (2017). Public-private wage differences in the Western Balkan Countries. Munich: Munich Personal RePEc Archive.

White, H. (1980). A Heteroskedasticity-Consistent Covariance Matrix Estimator and a Direct Test for Heteroskedasticity. Econometrica, 817-38. doi:10.2307/1912934

Williams, M., Gómez Grajales, C. A., & Kurkiewicz, D. (2013). Assumptions of Multiple Regression: Correcting Two Misconceptions. Practical Assessment, Research & Evaluation, XVIII(11), 1-14. Gjetur në https://pareonline.net/getvn.asp?v=18&n=11

SHTOJCË 1

Kodi:	Grup-profesioni:	Profesione të njohura të këtij grup-profesioni:
0	"Forcat e Armatosura"	Oficer ushtrie, major, toger, ushtar profesionist, çmontues armësh, oficer garde.
1	"Menaxherë"	Drejtor kompanie/seksioni/shkolle, pronar biznesi, administrator, menaxher biznesi/kompanie/dege.
2	"Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)"	Inxhinier, kontabilist, jurist, mjek, mësues, pedagog i arsimit të lartë, ekonomist, agronom, inspektor shëndeti, gazetar, informaticien.
3	"Teknikë dhe specialistë në zbatim"	Nurse, veterinary, lab technician, construction technician, tax collector, operations supervisor, desk secretary, police commissary, cameraman.
4	"Nëpunës"	Kasier, kambist valute, recepsionist, përgjegjës dyqani, furnitor malli, bibliotekar
5	"Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve"	Oficer policie, gardian sigurie, shitës dyqani, tregtues malli, kuzhinier, furrëtar, kamerier, banakier, berber, parukier, estetist, sanitar.
6	"Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit"	Bujk, blegtor, fermer, bari, peshkatar, kopshtar, rritës bletësh.
7	"Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to"	Mjeshtër ndërtimi, artizan, rrobaqepës, elektriçist, hidraulik, piktor, metalpunues, saldator, këpucar, kasap.
8	"Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve"	Drejtues taksie/kamioni, minator, punëtor fabrike/linje prodhimi, manovrator/drejtues makinerish të rënda.
9	"Punëtorë (Profesione elementare)"	Punëtor ndërtimi, shitës ambulant, shpërndarës ushqimi dhe pizza-sh, punëtor ngarkim-shkarkimi, kujdestar godine, pastrues rrugësh.

Burimi: Hoffmann, 1999; Këshilli i Ministrave, 2017

SHTOJCË 2

Grafiku 5. Të ardhurat mujore nga pagat sipas nivelit arsimor, për të punësuarit në sektorin privat dhe atë publik (kampioni i plotë 2002-2012)



Burimi: Të dhënat mikro të AMNJ, 2002-2012.

SHTOJCË 3

Primet e të ardhurave mujore nga pagat sipas sektorit të punësimit dhe nivelit arsimor – Shqipëria krahasuar me vendet e rajonit fqinj.

Tabela A. Primet e të ardhurave mujore nga pagat në sektorin publik, vendet e rajonit fqinj

Vendi:	Primi:		Periudha e sondazhit:	Burimi:
Greqia		35.7%	2004-2007	Depalo et al. (2013)
Italia		28.3%	2004-2007	Depalo et al. (2013)
Sllovenia		29.7%	2004-2007	Depalo et al. (2013)
Kosova	(burrat)	20.9%	2011	Shehaj et al. (2015)
Serbia		19.3%	2008-2011	Vladisavljevic et al. (2017)
Shqipëria		16%	2008-2012	Evidentim i këtij kërkimi
Maqedonia V.		15.7%	2008-2011	Vladisavljevic et al. (2017)

Tabela B. Të ardhurat mujore nga pagat sipas nivelit arsimor, në një përzgjedhje vendesh

	Indekset e pagës për nivelet arsimore; (arsimi i mesëm = 100):			
Vendi:	Fillor:	I mesëm:	I lartë:	Periudha e sondazhit:
Suedi	81.7	100	119.6	2016
Norvegji	76.4	100	130.3	2016
Danimarkë	81.2	100	130.9	2016
Estoni	88.6	100	134	2016
Itali	77.8	100	138.5	2014
Greqi	77.3	100	139.6	2016
Austri	68.7	100	146.2	2016
Finlandë	98.2	100	147.2	2015
Letoni	89.2	100	147.5	2016
Poloni	82.8	100	156	2016
Shqipëria	78.2	100	156.7	2002-2012
Republika Sllovake	64.8	100	167.9	2016
Çeki	74.3	100	169.3	2015
Turqi	71.8	100	171.3	2016
Lituani	85.7	100	179.3	2014
Hungari	76.1	100	194.1	2016
Mesatarja e B. Evropian	79	100	150.9	2014-2016
Shtetet e Bashkuara	74.2	100	174.9	2016

Burimi: OECD.Stat (2019) data and metadata repository, dhe evidentime të këtij kërkimi